

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015 – 2020

Raporti Vjetor i Monitorimit 2016

Tiranë, Mars 2017

Pasqyra e Lëndës

I.	Përmbledhje Ekzekutive	3
1.	Hyrje	6
2.	Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë.....	8
3.	Progresi i zbatimit të reformave në kuadër të secilit Prioritet	9
3.1.1.	Prioriteti I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit	9
3.1.2.	Prioriteti II: Organizimi dhe funksionimi i administratës publike.....	200
3.1.3.	Prioriteti III Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	255
3.1.4.	Prioriteti IV - Procedurat administrative dhe mbikëqyrja	333
4.	Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2016.....	47

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i progresit vjetor i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020 ka për qëllim të prezantojë progresin e përgjithshëm të zbatimit të kësaj strategjie bazuar në katër prioritet kryesore dhe si dhe nivelin e arritjes së objektivave respektive për vitin 2016.

Gjetjet e këtij raporti janë inkurajuese. Dy vjet pas fillimit të zbatimit të strategjisë në Prill 2014, **76% (62 nën-aktivitete nga 82 gjithsej) e nën-aktiviteteve të parashikuara në Strategji filluan të zbatohen, ndërsa 31 prej tyre janë realizuar plotësisht.** Në krahasim me vitin 2015 ku u mundësua realizimi i vetëm 6 aktiviteteve, për vitin 2016, janë realizuar plotësisht 25 nën-aktivitete, 19 nën-aktivitete më shumë.

Progres është arritur në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit strategjik dhe mirëkordinimit të politikave dhe projekteve në sektorë të ndryshëm. U miratua Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim-II 2015-2020 si dhe 25 dokumenta strategjikë (në kuadër të SKZHI-së). Gjithashtu u përditësua dhe u iniciua cikli i dytë i Paketës Kombëtare të Projekteve të Relevancës Strategjike për 5 sektorë prioritarë: transport, energji, mjedis; infrastrukturë sociale dhe sektori i infrastrukturës së biznesit. Krahasuar me vitin 2015 është arritur një përqasje më koherente me planifikimin buxhetor afatmesëm duke ulur hendekun financiar rreth 29% për vitin 2016 (94% në vitin 2015, në 65% në vitin 2016). Falë një prioritizimi të mirëkoordinuar u mundësua aprovimi i 7 fondeve/grant përmes skemave të Bashkimit Europian, si pjesë e Paketës Unike Kombëtare të Projekteve të Relevancës.

U arrit progres në ngritjen e sistemit të integruar të informacionit mbi zhvillimin dhe monitorimin e politikave i cili kontribon drejt **qasjes dhe orientimit ndaj performancës në planifikimin e politikave** dhe proceseve buxhetore dhe me qëllim përmirësimin e kapaciteteve institucionale për të monitoruar rezultatet në nivelet e strategjisë. U miratua dokumenti i dizenjimit të Sistemit të Informacionit për **Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPSIS)**¹ si dhe përfunduan procet respektive për finalizimin e kontratës me qëllim operacionalizimin e **Sistemit të Informacionit për Manaxhimin e Ndhmës së Huaj (EAMIS)**. Të dy sistemet do të mundësojnë efikasitetin e qeverisë në ndjekjen e statusit të zbatimit të politikave dhe strategjive nëpërmjet forcimit të mekanizmit monitorues bazuar në rezultate.

U arrit progres në plotësimin e mekanizmave ligjore e insitucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Në Tetor të vitit 2016 u lancua Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik www.konsultimipublik.gov.al i cili është një instrument i rëndësishëm për realizimin e procesit të konsultimit publik në përputhje me standartet që kërkon ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Përdorimi korrekt i Regjistrisë Elektronike për Njoftimin dhe Konsultimin publik do të ndihmojë në rritjen e standartit të hartimit të legjislacionit duke e bërë këtë proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Megjithatë rritja e përdorimit nga ana e ministrive e RENJKP për procesin e konsultimit publik, vendosja e një sistemi raportimi të qenderzuar si dhe publikimi i raporteve të konsultimit janë ende fusha për t’u përmirësuar.

¹ Information System for Integrated Planning Systemw

Si pjesë e reformës territoriale dhe fuqizimit të bashkive të reja, fokusi ka qënë **të sigurohet mbështetja metodologjike për organizimin dhe funksionimin e njësive të reja administrative të vendit dhe forcim të kapaciteteve zbatuese**. Brenda tremujorit të parë të 2016 me ndihmën e Projektit Star/ PNUD të gjitha bashkitë u pajisën me një model organizimi, i hartuar sipas tipit të bashkisë. Deri në fund të 2016 janë asistuar 30 bashki lidhur me aplikimin e 4 modeleve të organizimit të njësive të reja të propozuara dhe të financuara nga Këshilli i Evropës. Ky proces do të vazhdojë në vitin 2017 në të cilin do të asistohen 20 bashki të tjera. Në kuadër të forcimit të kapaciteteve për menaxhimin e burimeve njerëzore janë trajnuar me Programin e Këshillit të Europës 122 nëpunës civil të pushtetit vendor.

Progresi i arritur gjatë vitit 2016 konsiston në hartimin e kuadrit të politikave dhe atij ligjore, si dhe përparimi drejt ndërtimit gradual të infrastrukturës së nevojshme të operimit për ofrimin e shërbimeve. U miratuan dokumentat politike afatgjata dhe ligjore për Ofrimin e Shërbimeve me në Qendër Qytetarin. Në nëntor 2016 u ngrit Qendra parë e Integruar për Ofrimin e Shërbimeve Publike në Kavajë (qendra e parë me një ndalesë), ku ofrohen shërbimet në sportel të 5 institucioneve publike. Gjithashtu në tërësi është bërë e mundur të ofrohen 206 shërbime. Vendosja e standardeve të reja të mënyrës së ofrimit të shërbimit ndaj klientit në sportel (si në Zyrën Pritëse të ADISA pranë ZVRPP Tiranë ashtu dhe në Qendrën e Integruar Kavajë) rezultojnë të kenë përmirësuar ndjeshëm mënyrën e menaxhimit të rradhës së pritjes për marrjen e shërbimit, duke reduktuar atë dhe duke rritur kënaqësinë e qytetarëve lidhur me cilësinë e shërbimeve. **Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore të ofruara me standarte të përmirësuara u rrit 4 herë duke arritur në 206 shërbime, ndërsa numri i sporteleve në shërbim të qytetarëve me standarte të përmirësuara u rrit nga 15 në 25 sportele.** Nga tetori 2016 qytetarët informohen për mënyrën e përfitimit të 420 shërbimeve të 10 institucioneve edhe nëpërmjet shërbimit Call Center ADISA, duke përmbushur nevojën e informimit të qytetarëve për mënyrën e përfitimit të shërbimeve publike, të ofruara nga 10 institucione.

Janë hedhur hapa të mëtejshëm në drejtim të vlerësimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore. Të gjitha këto masa synojnë të sigurojnë paanshmërinë dhe garantimin e një procesi rekrutimi transparent, të paanshëm dhe meritokratik. Tezat e testimit për procedurat e rekrutimit të organizuara gjatë vitit 2016, janë gjeneruar dhe korigjuar automatikisht nëpërmjet sistemit elektronik, në bazë të fushës së njohurive për secilën procedurë. **Është pasuruar dhe përmirësuar më tej banka e pyetjeve, nëpërmjet së cilës tezat e testimit gjenerohen automatikisht në bazë të fushës përkatëse të njohurive, duke kontribuar drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe profesionalizmit në organizimin e procedura të rekrutimit.**

Progres është arritur në drejtim të zhvillimit e shtrirjes së mëtejshme të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) në institucionet e administratës publike. Gjatë vitit 2016 u hodh në sistem informacioni për mbi 11000 të punësuar në 330 njësi shpenzuese pjesë të shërbimit civil. Janë përfshirë në SIMBNJ të gjitha strukturat/organigramat e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil dhe ka nisur puna për përfshirjen e njësive të qeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura. U zhvillua dhe integrua në sistem **funksioni i përlllogaritjes së pagave bazuar në skemat dhe kategoritë e tyre.** Moduli i pagave të HRMIS do të bëjë të mundur jo vetëm gjenerimin automatik të pagave duke siguruar një saktësi më të lartë cilësie të informacionit dhe kontroll më të madh në menaxhimin e fondit të pagave.

Zhvillimi i Infrastrukturës së TIK me synim rritjen e eficienten e punës së administratës publike si dhe përmirësimin e transmetimit dhe rrjedhjen e informacionit ka shënuar progres me prezantimin e projektit për menaxhimin e dokumentit elektronik në administratën publike (EDRMS) duke përcjellë një vizion të qartë për rritjen e eficientës dhe efektivitetit brenda qeverisë

shqiptare. Kjo platformë ndikon drejtpërdrejt në uljen e barrierave administrative rrjedhimisht ndikon në një performacë të lartë të veprimtarisë të administratës publike. Projekti i ERDMS është pilotuar për herë të parë në Kryeministri, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë si dhe Ministrinë e Transportit.

U avancua në drejtim të ofrimit të shërbimeve on-line që mundësojë ofrimin e më shumë shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe vet qeverinë. Portali qeveritar e-albania u pasurua dhe ofroi me shume shërbime. Është pasuruar me 217 shërbime të reja elektronike të nivelit 3 dhe 4 sipas klasifikimit të UNPAN 2014, duke arritur një total prej 465 shërbimesh elektronike. Kjo shifër shënon një rritje prej 33 herësh krahasuar me vitin 2013 si dhe një rritje pothuajse dyfish krahasuar me vitin 2015. Gjithashtu në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit u lidhën 5 institucione të tjera për të shkëmbyer të dhëna në kohë reale duke e rritur numrin total të institucioneve të lidhura në 42 ose 7 herë më të madh se ai në vitin 2013 ose 2.24 herë më shumë se viti 2015. Gjatë vitit 2016 ka përfunduar me sukses shpërndarja e 15 sporteleve dixhitale e-albania në qytetet më të rëndësishme në Shqipëri.

Progres u arrit në zbatimin e aktiviteve që lidhen më forcimin e regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publike, rasteve të konfliktit të interesave, si dhe mbrojtjes të të drejtave të sinjalizuesve për rastet e deklarimit të veprimeve auzive apo korrupsionit. Në Qershor 2016 u miratua Ligji nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” si dhe u hartua kuadri nën-ligjor duke hedhur bazat për instalimin e një mekanizmi për parandalimin e korrupsionit, i njohur dhe pranuar nga praktikantët më të mira në botë.

Hartimi dhe miratimi i programeve të transparencës nga ana e Autoriteteve publike mbetet ende problematik por ka një numër në rritje të institucioneve që kanë përmbushur këtë detyrim. Gjatë vitit 2016 programet e transparencës u zhvilluan në 46 institucione më shumë, por ende mbeten problem kapacitetet njerëzore dhe financiare për zbatimin sic duhet të ligjit për të drejtën e informimit.

Ende mbetet shqetësim reagimi në kohë nga ana e institucioneve publike ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit. Ka një rritje të numrit të rekomandimeve të pranura në tërësi nga institucionet e Administratës Publike, por është ulur përqindja e rekomandimeve të zbatuara. Ndërkohë që edhe lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2016 janë më shumë rekomandime pa përgjigje, krahasuar me vitin 2015.

1. HYRJE

Reforma në administratën publike në Shqipëri është thelbësore në procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Një administratë publike profesionale, e bazuar në meritokraci dhe e aftë për të ofruar shërbime cilësore ndaj publikut, është një parakusht për qeverisjen transparente dhe demokratike. Një kornizë strategjike e mirëpërcaktuar përmbën themelet mbi të cilat do të ndërtohet zbatimi i reformës në administratën publike.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, e miratuar në muajin Prill 2015, shërben si një dokument strategjik që orienton reformimin e administratës, bazuar në katër shtylla kryesore, objektiva të qarta dhe një plan veprimit me aktivitete konkrete.

Marrja e statusit të vendit kandidat në 24 qershor 2014, shënon një hap të rëndësishëm përpara në procesin e integritetit evropian, proces i cili kërkon një administratë profesionale dhe kapacitete njerëzore e materiale për të mundur jetësimin e politikave dhe objektivave kombëtare, të ndërmarra në kuadër të përmbushjes së detyrimeve në këtë drejtim.

Në këtë kontekst, Strategjia udhëhiqet nga vizioni:

“Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integritetit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efikente.”

Zbatimi i tij mbështetet në reformat që do të ndërmerren në katër fusha kryesore prioritare që synojnë përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të :

- Sistemit të politikbërjes dhe cilësisë së legjislacionit;
- Mënyrës së organizimit të administratës publike;
- Shërbimit Civil dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Procedurave administrative dhe mbikëqyrjes;

Zbatimi i Strategjisë realizohet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2015-2017. Për të mbikëqyrur ecurinë e progresit të bërë, funksionon një sistem i rregullt monitorimi dhe vlerësimi mbi bazën e të cilit, gjatë vitit 2015-2016 janë përgatitur 8 raporte periodike për periudhat 3-mujore të cilat kanë në fokus monitorimin e vazhdueshëm të realizimit të aktiviteteve.

Ndërsa arritjet e zbatimit të strategjië dhe impakti i saj vlerësohet mbi baza vjetore, nëpërmjet vlerësimit të treguesve të suksesit të përcaktuar sipas objektivave të Strategjisë. Ky raport është raporti i dytë i vlerësimit të arritjeve të strategjië.

Raportet 3-mujore dhe Raporti Vjetor hartohen nga Departamenti i Administratës Publike dhe Sekretariati i Grupit për Menaxhimin e Politikave të Administratës Publike, pranë Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Raportet e monitorimit janë hartuar në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira si dhe janë diskutuar në Grupin Tematik “*Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore*”, e më pas miratuar në Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike.

Raportet e prodhuara dhe rezultatet shërbejnë si një bazë për të dhënë informacionin e duhur gjatë procesit që po kryhet aktualisht, të vlerësimit afatmesëm të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike. Fokusi i vlerësimit afatmesëm do të jetë progresi i zbatimit të Strategjisë për periudhën 2015-2017 (mesi i vitit 2017). Ky vlerësim do të evidentojë arritjet e dy viteve të para të strategjisë në lidhje me rezultatete parashikuara dhe nivelin e arritjes së objektivave të strategjisë. Ai do të shërbejë si bazë për të vlerësuar nivelin e arritjeve të objektivave për dy vitet e para të zbatimit të strategjisë dhe do të ndihmojë për orientimin e politikave të parashikuara në Strategji drejt arritjes së qëllimeve finale të strategjisë, si dhe në drejtim të orientimit të aktiviteteve për periudhën 2018-2020. Procesi i vlerësimit të strategjisë do të fillojë në muajin Mars dhe pritet të përfundojë në muajin Korrik 2017.

2. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI PROGRESIN E STRATEGJISË

Si edhe u përmend më lartë, vlerësimi i progresit të bërë për arritjen e objektivave të Strategjisë realizohet nëpërmjet vlerësimit të treguesve të suksesit të parashikuar në dokumentin e Strategjisë. Ndërsa vlerësimi i ecurisë së zbatimit të reformave të parashikuara në kuadër të strategjisë bazohet në vlerësimin e ecurisë së zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2015 - 2017 (PVRAP).

Plani i Veprimit parashikon zbatimin e 53 aktiviteteve bazë dhe 82 nën-aktiviteteve. Për efekte të monitorimit 82 nënaktivitetet janë konsideruar dhe referohen, më poshtë në raport, si aktivitete të veçanta.


Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra përsa i përket realizimit të produkteve dhe të aktiviteteve në përgjithësi, procesi i monitorimit është kryer në nivel produkti. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. DAP ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë javës së dytë të muajit Shkurt 2017.

Deri më tani janë nën zbatim 62 nën-aktivitete nga 82 gjithsej të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë (grafiku 2).


Nga një total prej 62 aktiviteteve, 31 (ose 50 %) prej tyre janë të realizuara plotësisht deri më tani (grafiku 3).

Për vitin 2016, janë realizuar plotësisht 25 aktivitete, 19 aktivitete më shumë krahasuar me vitin 2015 në të cilin u realizuan vetëm 6 aktivitete (Grafiku 1).


Grafiku 1. Masat e zbatuara në deri në fund të 2016.



Grafiku 2: Statusi i Përgjithshëm i Zbatimit të Aktiviteteve



Grafiku 3: Ecuria e zbatimit të produkteve



3. PROGRESI I ZBATIMIT TË REFORMAVE NË KUADËR TË SECILIT PRIORITET

3.1.1. Prioriteti I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit


Objektivat kryesore në fushën e politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit në Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike fokusohen në:

- *Përmirësimin e planifikimit e koordinimit të politikave për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete*
- *Zbatimi i një sistemi transparent e gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis*
- *Ndërtimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: (i) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanes dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe (ii) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi i politikave.*


Krahasuar me 2015, përgjatë vitit 2016, kanë filluar zbatimin 4 aktivitete të reja dhe janë realizuar plotësisht 8 aktivitete. Siç paraqitet në grafikët 4 dhe 5 më poshtë, në total kanë qenë në zbatim 23 aktivitete nga 30 nën-aktivitetet e parashikuara për këto objektiva.

Më shumë progres është arritur në Objektivin 2 “Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis”, i cili ka numrin më të madh të aktiviteteve të realizuara plotësisht.

Grafiku 4: Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 5: Statusi i realizimit të nën-aktiviteteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektiv

Nga 13 aktivitete të parashikuara nën **Objektivin 1: “Përmirësimi i planifikimit e koordinimit të politikave për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete”** pjesa më e madhe e tyre (10) kanë filluar tashmë zbatimin dhe 3 aktivitete janë realizuar tërësisht deri në 2016.

Progres është arritur në drejtim të zhvillimit të më tejshëm të kuadrit strategjik. Në këtë kuadër është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.348, datë 11.05.2016, Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim-II 2015-2020 (SKZHI). Ky dokument parashtron drejtimet strategjike kryesore të zhvillimit të vendit, për një periudhë 5-vjeçare, jo vetëm të lidhur me zhvillimin kombëtar, por edhe duke siguruar njëherësh orientimin e politikave për një bashkëpunim efektiv rajonal, si edhe për rritjen e konkurrueshmërisë, përmes një qasje rajonale për sa i takon lidhjeve të vendeve të Ballkanit me BE-në.

Gjithashtu, dokumenti reflekton axhendën për një zhvillim të qëndrueshëm në nivel global, të lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke synuar arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në tre dimensionet e tij – atë ekonomik, social dhe mjedisor – në mënyrë të ekuilibruar dhe të integruar.

SKZHI-II paraqet sesi do të arrihet drejt përmbushjes së vizionit për zhvillimin edhe integrimin e vendit, përmes politikave dhe strategjive që synojnë:

1. Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeruar rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;
2. Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjeve të të drejtave të tyre;
3. Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde, që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
4. Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrencën dhe perspektivën ekonomike të Shqipërisë, përmes një mjedisi biznesi më konkurrues e novator dhe përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve, si edhe konkurrencën me vendet e rajonit dhe më tej.

Strategjia bazohet mbi modelin e rritjes ekonomike të gjeneruar nga nxitja e potencialeve ekonomike vendore e rajonale, përmes politikave strukturore dhe sektoriale efikase, si edhe nxitjes së konkurrueshmërisë dhe novacionit. Dokumenti paraqet perspektivën dhe objektivat lidhur me

zhvillimin e rajoneve të vendit, si një qasje zhvillimore për të potencuar polet e zhvillimit ekonomik vendor e rajonal, me qëllim gjenerimin e rritjes dhe të mirëqënies së qytetarëve.

Në aspektin e planifikimit, SKZHI-II 2015 – 2020 është një komponent dhe instrument kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)²³, nëpërmjet të cilit garantohet procesi i planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë duke siguruar lidhjen e integruar midis dokumentave strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale, të cilat udhëheqin politikëbërjen në nivel të lartë në përcaktimin e përparësive dhe qëllimeve strategjike kombëtare.

Dokumenti i SKZHI është i harmonizuar në pikëpamje të përmbajtjes dhe të periudhës kohore me një sërë dokumentesh strategjike, të cilët janë hartuar në të njëjtën periudhë kohore me këtë dokument. Duhet theksuar se procesi i hartimit të SKZHI-II ka ecur paralelisht me dokumentet programuese të institucioneve për sektorët, si edhe me një sërë raportesh dhe dokumentesh programuese të hartuara nga partnerët për zhvillim, në kuadër të programimit të fondeve për zhvillim. Kjo ka krijuar një sinergji në prioritzimin e politikave dhe programimin e fondeve për reformat për zhvillim dhe integrim të vendit.

Periudha kohore 2015-2020 e SKZHI-II është e harmonizuar me periudhën e planifikimit financiar të Bashkimit Evropian (BE) 2014-2020, strategjinë e Lizbonës së BE-së deri në 2020, dhe me tre ciklet e Kuadrit Buxhetor Afatmesëm, me të cilat është e harmonizuar SKZHI-II. Risia e këtij dokumenti paraqitet **në fokusimin në prioritetet kyçe të qeverisë**⁴ si edhe në hartimin e tij bazuar në parimin e “politika të orientuara drejt rezultave, **politikat dhe prioritetet programohen për herë të parë të pajisur me tregues dhe synime të qarta, të matshme dhe konkrete**, të cilat do të monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e strategjisë dhe ndikimin e saj në çuarjen përpara të zhvillimit të vendit”.

Janë përzgjedhur 50 tregues kryesorë të cilët paraqesin synimet që planifikohen të arrihen nga everia në periudhën 2016 -2020 . Këta tregues do të masin progresin e zhvillimit dhe integritetit të vendit, të cilët orientojnë programimin e politikave dhe masave konkrete për arritjen e tyre, si kusht për arritjen e objektivave dhe synimeve të SKZHI.

Treguesit e monitorimit të zbatimit, në total 50 tregues, janë të grupuar në dy grupe:

- 1) Tregues të nivelit të lartë të zhvillimit me synime të përcaktuara, që përfshijnë: treguesit e nivelit të lartë makroekonomikë dhe treguesit në kuadër të angazhimeve integruese, të dakortësuar me BE-në, dhe;
- 2) Treguesit e zhvillimit sipas sektorëve, për targetet e të cilave jepen referencat në dokumentat strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale, të cilët përfshijnë: treguesit sektorialë në lidhje me mirëqeverisjen dhe konkurrueshmërinë dhe treguesit sektorialë në lidhje me politikat sociale dhe qëndrueshmërinë e burimeve.


Strategjitë sektoriale & ndërsektoriale kombëtare dhe gjithë kuadri i dokumentave strategjike janë instrumenti kryesor për të siguruar planifikimin strategjik të orientuar nga vizioni politik për zhvillimin e vendit. Strategjitë konceptohen si instrumente që përthyehen dhe zbërthehen në programe për të siguruar zbatueshmërinë dhe jetësimin e tyre, në nivel sektorial apo ndërsektorial. Një rëndësi e vecantë ju kushtua gjatë fazës së hartimit të strategjive dhe sigurimit të cilësisë së

² VKM nr.692, 2005 "Per sistemin e planifikimit të Integruar në Shqipëri"

³ Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) është një tërësi parimesh operative që siguron realizimin, në mënyrë sa më të efektshme dhe të harmonizuar, të planifikimit dhe monitorimit të politikave të qeverisë në tërësi. Nëpërmjet SPI synohet siguri i lidhjes midis politikave dhe mundësive reale të financimit nëpërmjet procesit të buxhetimit afat-mesëm, ose Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA), për realizimin e objektivave të politikave si hapa të ndërmjetme për përmbushjen e SKZHI-II

⁴ Të cilat monitorohen në lëvrin e tyre nga Njësia/Njësitë e Jetësimit të Prioriteteve,

dokumentave të hartuara, me qëllim që ato të mbështeteshin jo vetëm në një kuadër monitorimit të qartë, (me plan veprimi dhe tregues monitorimi të përcaktuar qartë), por dhe brënda një kuadri financiar të përballueshëm dhe të lidhur sa më ngushtë me burimet financiare dhe Programin Buxhetor Afatmesëm. Në këtë kontekst, deri në fund të vitit 2016, janë miratuar me vendim të këshillit të ministrave 25 dokumenta strategjikë (në kuadër të SKZHI-së) dhe 5 strategji janë akoma në fazë draftimi. Në këtë kuadër baza e kuadrit strategjik të sipërcituar ka orientuar hartimin për vitin respektiv në 3 dokumentave planifikues sektoriale (drejtësia, reforma për menaxhimin e integruar të ujit dhe konkurrueshmëria & inovacioni) dhe 2 programeve për reformën sektoriale (anti-korrupsionin dhe transportin).



Për vitin 2016 me asistencën e OECD/SIGMA është zhvilluar një analizë për 22 strategjitë dhe planet e tyre të veprimit, që lidhet me një shqyrtim të detajuar të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Aspektet e gjetjeve lidhur me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale janë analizuar për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta që kanë ndikim në cilësinë e monitorimit dhe të raportimit, të cilat janë të vlefshme në këtë rast përmirësimin e fazës së planifikimit dhe zhvillimin e kuadrit strategjik.

Analiza dhe shqyrtimi i detajuar në kuadër të përmirësimit të fazës së planifikimit lidhet me aspektet e mëposhtme:

- Cilësinë e objektivave të përcaktuara në strategjinë;
- Përdorimin e treguesve;
- Përcaktimin i aktiviteteve dhe rezultateve;
- Kuadrin institucional për monitorimin;
- Frekuenca e raportimit;

Duke qenë se realizimi i një sistemi eficient si në kuadër të planifikimit dhe në atë monitorimit dhe raportimit kërkon dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin e tyre, Njësia me asistencën e OECD/SIGMA po ndërmerr një proces të vlerësimit të kapacitetve brenda ministrive të linjës, përgjegjëse për, hartimin, zbatimin dhe raportimin e strategjive. Ky vlerësim do të ndihmojë në marrjen e masave të mëtijshme për rritjen e burimeve njërezore dhe kapaciteteve ekzistuese me qëllim zhvillimin e një sistemi cilësor dhe efektiv në strukturat qendrore të qeverisë dhe ministrive të linjës.


Lidhur me hartimin e kuadrit strategjik referues (strategji ve sektoriale dhe ndërsektoriale) nga analizat e zhvilluara gjatë vitit 2016, rezultojn se:

- Në përgjithësi strategjitë sektoriale & ndërsektoriale priren të jenë në përputhje me Urdhrin aktual të përgatitjes së kuadrit strategjik, duke përfshirë kapitujt kryesorë që lidhen me burimet e financimit dhe sistemin e monitorimit.
- Të gjithë strategjitë përfshijnë një plan veprimi zbatimi afatmesëm, që mbulon një periudhë kohore afatmesëm dhe një afatgjatë (5 vjet).
- Në çdo strategji ka një cilësi relativisht të mirë të objektivave të përcaktuara. Sasia e objektivave (numri) është i balancuar mirë në përgjithësi me një mesatare prej 3-5 objektivash që do të përmbushen në secilën shtyllë.
- Të gjitha strategjitë tregojnë strukturën që është e ngarkuar me koordinimin dhe monitorimin e strategjive.
- Kuadri strategjik i hartuar në përgjithësi është i lidhur buxhetimin afatmesëm, duke rezultuar se hendeuku financiar nuk akumulon jo më shumë se 30% të fondeve të akomoduar për politikatat respektive.

Në vijim të rritjes së shkallës së koordinimit të iniciativave publike dhe sigurimit të harmonizimit të ndërhyrjeve në sektorë të ndryshëm ka vazhduar funksionimi i Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave⁵, i cili ofron një qasje të integruar për koordinimin dhe menaxhimin e programimit, zbatimit dhe monitorimit të performancës së programeve sektoriale për arritjen e Integritimit Europian të Shqipërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Janë ngritur sekretariatet teknike në secilën prej tyre, të cilat po luajnë një rol të rëndësishëm në koordinimin e përditshëm të procesve, por ndihet nevoja e shtimit dhe forcimit të kapaciteteve për këtë qasje të re. Përsa i përket sektorëve të tjerë ka disa zhvillime në kuadër të Grupeve tematike. Grupi Tematik i Transportit dhe grupi tematik për Zhvillimin Rural.

Box 1/Tabela 1:

Draft-Paketa Kombëtare të Projekteve të Relevancës Strategjike, NSPP 2016/2017




Gjithashtu po në kuadër të mirë-kordinimit të politikave dhe projekteve në sektorë të ndryshëm **një tjetër progres lidhet me procesin e përditësimit dhe incimit të ciklit të dytë të Paketës Kombëtare të Projekteve të Relevancës Strategjike,⁶ për 5 sektorë prioritarë: transport,**

⁵ 4 Grupe të Menaxhimit të Integruar të Politikave, janë krijuar dhe funksionojnë sipas Urdhërit të Kryeministrit Nr.129/2015: Qeverisja e mirë dhe Reforma në Administratën Publike ; Menaxhimi i Integruar i Ujit; Punësimi dhe Sektori; Social; Konkurrueshmëria dhe Inovacioni.

⁶ National Strategic Projects Pipeline

energjë, mjedis (ujësjellës-kanalizime; mbrojtja nga përmbytja; ndotja e ajrit) **sektori infrastrukturës sociale** (arsim & sport; shëndetësi; art-kulturë; mbështetja për burgjet; strehimi) dhe **sektori i infrastrukturës së biznesit** (marinat, turizmin dhe infrastrukturën e marinave & broadband). Ky proces është duke u finalizuar. Në PKPS janë duke u marrë në konsideratë dhe projektet me efekt ndërkufitar si projekte iniciuese që do të lancohen në Samitin e Italisë. **Krahasuar me vitin 2015 është arritur një përqasje më koherente me planifikimin buxhetor afatmesëm duke ulur hendekun financiar rreth 29% për vitin 2016** (94% në vitin 2015, në 65% në vitin 2016) të paraqitura më sipër (box1).

Një priorizim i mirëkoordinuar mundëson një proces të duhur për thithjen e fondeve/grant përmes skemave të Bashkimit Europian aktualisht, nga lista e Paketës Unike Kombëtare të Projekteve të Relevancës Strategjike Qeveria Shqiptare ka përfituar grante **7 projekte për asistencë teknike dhe 2 projekte për investime**, si bashkëfinancim (projektet për asistencë teknike, mund të kenë perspektive për ndërhyrje si investime në infrastrukturë, në periudhën afatmesme).



Shqipëria renditet e katërta për vitin 2015, për nivelin e përfitimit nga fondet e shpërndara përmes mekanizmit të WBIF me 17 mln Euro, pas Malit të Zi (52 mln Euro), Kosovës (42 mln Euro), Bosnjës (31 mln Euro).

Ndërsa për vitin 2016 renditet e dyta në Rajon me 36%, pas Serbisë (41%), Kosova (15%), Maqedonia (4%) dhe Mali i Zi (3%) për thithjen e fondeve, krahasuar me vendin e katërt (10%) në vitin 2015.

Shqipëria ka thithur 27,265,000 më shumë fonde në 2016 krahasuar me vitin 2015

Progresi i mësipër i realizimit të aktiviteteve ka sjellë një përmirësim të dukshëm të rezultateve të synuara në kuadër të objektivit I:

Grafikë e mëposhtëm prezantojnë progresin e arritur në drejtim të synimeve të vendosura nga viti 2015 në vitin 2016.

87,75% e kuadrit rregullator strategjik (strategjitë sektoriale nën SKZHI) ka arritur të hartohet dhe të vihet në zbatim deri në fund të vitit 2016, krahasuar 83% në vitin 2015

Niveli Treguesit 2015



Niveli i Treguesit 2016



85,7% e strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të përfunduara dhe me cilësi (me plan veprimi të kostuar dhe me set indikatorësh me synimet përkatëse) të aprovuara në vitin 2016, krahasuar 70% në vitin 2015

Niveli Treguesit 2015




Niveli i Treguesit 2016




33,6% e stafëve politikëbërës në ministrinë e linjës gjatë viti 2016 u trajnuan dhe forcuan kapacitetet për çështje të planifikimit strategjik, në krahasim me 20% të arritura në vitin 2015.

Niveli 2015



Niveli 2016



Në kuadër të qasjes dhe orientimit ndaj performancës në planifikimin e politikave dhe proceseve buxhetore dhe me qëllim përmirësimin e kapaciteteve institucionale për të monitoruar rezultatet në nivelet e strategjisë dhe të programit ka nisur procesi ngritjes së një sistemi të integruar të informacionit lidhur me zhvillimin dhe monitorimin e politikave, pas vlerësimit të nevojave në lidhje me planifikimin strategjik dhe planifikimin e politikave publike është përfunduar dhe miratuar dokumenti i dizajnimit të Sistemit të Informacionit për **Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPSIS)⁷ si dhe janë zhvilluar demostrimet live të ofertave respektive. Gjithashtu janë përfunduar proceset respektive për finalizimin e kontratës me qëllim operacionalizimin e **Sistemit të Informacionit për Manaxhimin e Ndihmës së Huaj (EAMIS)**.**

Të dy sistemet do të mundësojnë efikasitetin e qeverisë në ndjekjen e statusit të zbatimit të politikave dhe strategjive nëpërmjet forcimit të mekanizmit monitorues bazuar në rezultate. Kjo do

⁷ Information System for Integrated Planning System

të bëhet duke krijuar një hierarki të qartë të rezultateve kryesore të treguesve të strategjisë dhe të politikave, bazuar në treguesit e programit të pasqyruar në planifikimin buxhetor afatmesëm dhe më gjërë.

Gjithashtu në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) është realizuar procesi pilot për zhvillimin dhe testimin e objektivave dhe treguesve të qeverisjes në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) post-2015 të Kombeve të Bashkuara. Pilotimi ka përmasa kombëtare dhe botërore. **Në nivel kombëtar, procesi pilot siguroi integrimin e masave dhe treguesve të performancës së qeverisjes së mirë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020)** si dhe për rritjen e kapaciteteve për mbledhjen, monitorimin dhe analizimin e të dhënave për treguesit e përzgjedhur si bazë për strategjinë. Në nivel botëror, ky proces mbështet Qeverinë Shqiptare (QSH) që të ndajë përvojën e saj për të informuar për zhvillimin e kuadrit pasues të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) ose të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) për axhendën post-2015 në fushën e “shtetit të së drejtës, institucioneve të afta dhe efektive”.

Ky proces e fokuson fushën e veprimit të tij kryesisht në parimet që mbështesin qeverisjen e mirë dhe novatore: llogaridhënia, transparenca, pjesëmarrja dhe parashikueshmëria.

Në kuadër të **Objektivit 2: "Sistem transparent e gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis"**, kanë filluar të zbatohen 8 (tetë) nga 12 nënaktivitetet e parashikuara, ndërkohë që 4 (katër) prej këtyre nënaktiviteteve janë realizuar plotësisht deri në 2016.

Është arritur progres në plotësimin e mekanizmave ligjore e insitucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Pas miratimi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.10.2015 “Për miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrat Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, u implementua në Tetor të vitit 2016, Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENjK) i cili është tashmë i aksesueshëm për të gjithë në linkun www.konsultimipublik.gov.al.


Me lancimin e RENjK, është bërë i mundur përdorimi i një instrumenti të rëndësishëm për realizimin e procesit të konsultimit publik në përputhje me standartet që kërkon ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Përdorimi korrekt i Regjistrat Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin publik do të ndihmojë në rritjen e standartit të hartimit të legjislacionit duke e bërë këtë proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit 2016 janë aprovuar në Këshillin e Ministrave 119 ligje ndër të cilat 63 kanë qënë subjekt i ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Ministrinë kanë realizuar në masën 87% objektivin e tyre të konsultimit të këtyre ligjeve, duke konsultuar 53 ligje dhe duke lënë 8 prej tyre të pakonsultuara.

Të dhënat mbi aktet ligjore të hartuara dhe që kanë kaluar procedurën e konsultimit publik në total dhe sipas ministrive

Grafiku 5: Total



Burimi: Ministri Shtetit për Marrdhënie me Parlamentin

Në vëmendje të monitorimit ka qenë jo vetëm kryerja e procesit të monitorimit, por dhe vlerësimi i cilësisë së këtij procesi. Në 2015, nga vlerësimi i bërë i cilësisë së procesit të konsultimit rezultonte se ministrinë ishin larg kryerjes së procesit të konsultimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ligji. Plotësimi i kërkesave të ligjit nga vlerësimi konsiderohej në nivelin 60%, ose 5.25 pikë⁸

Ndërkohë në vitin 2016, kemi një rritje të cilësisë së konsultimit e cila është vlerësuar me 6.17 nga 8 pikë maksimum.


Përqindja e akteve ligjore të cilat kanë kaluar një proces të gjerë konsultimi publik dhe provat e përfshirjes së publikut dhe aktorëve të interesuar në proces në vitin 2016 është në nivelin 87%. Cilësia e procesit të konsultimeve vlerësohet të jetë në nivelin 6,17 pikë nga 8 pikë (vlerësimi maksimal). Krahasuar me vitin 2015 vërehet një trend në zbritje të vlerës së indikatorit për nivelin e ligjeve që kanë kaluar në konsultim publik (97% në 2015) dhe një trend rritës për indikatorin e cilësisë së konsultimit (5.25 në 2015)

Ndër ministrinë që i kanë plotësuar kriteret janë Ministria e Financave, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratë e Publike dhe Ministria e Drejtësisë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet shkallën e zbatimit të ligjit në total dhe sipas të dhënave të të gjitha ministrive, të cilat për aktet ligjore që nxjerrin duhet të ushtrojnë procedurën e konsultimit publik.

Grafiku 6: Numri i ligjeve të aprovuara dhe që kanë kaluar procesin e konsultimit sipas ministrive

⁸ Vlerësimi i sistemit të cilësisë së procesit të konsultimit bëhet duke u bazuar në shkallën 0-8, ku 0 përcakton rastet kur asnjë nga kërkesat e ligjit nuk është respektuar nga ministrinë dhe 8 = gjithë kërkesat e ligjit janë respektuar me korrektësi.



Burimi: Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Megjithatë, ngelen ende sfida për t'u kapërcyer. Rritja e përdorimit nga ana e ministrive e RENJKP për procesin e konsultimit publik, është një ndër synimet kryesore përse i përket hapave të ardhshëm. Gjithashtu, vendosja e një sistemi raportimi të qendër zruar si dhe publikimi i raporteve të konsultimit, janë ende fusha për t'u përmirësuar.

Në kuadër të **Objektivit 3 “Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanes dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi”** të gjithë aktivitetet (5) që përmban ky objektivi kanë filluar zbatimin, ndërkohë që 1 nga aktivitetet është realizuar plotësisht deri në fund të vitit 2016.

Monitorimi i zbatimit të strategjive është një proces shumë i rëndësishëm i cili siguron jo vetëm rritjen e përgjegjshmërisë dhe forcimin e llogaridhënies lidhur me arritjen e masave dhe objektivave të caktuara në secilën strategji të aprovuar nga qeveria, por mbi të gjitha është edhe një proces që ndihmon vendimarrësit në pasqyrimin e qartë të ecures së zbatimit të reformave të ndryshme sektoriale, evidentimin në kohë të problematikave të ndryshme që mund të shoqërojnë procesin e zbatimit të strategjive.


Është hartuar draft kuadri rregullator për monitorimin dhe raportimin e kuadrit strategjike, e cila është konsultuar dhe diskutuar:

- o në **takimin e Grupit Tematik Politikëbërjes (IPMG-PAR)** të zhvilluar në 20/11/2016, me pjesëmarrjen e Departamentit të Monitorimit të Legjislacionit, Departamentit të Jetësimit të Prioriteteve, Ministrinë e Integritetit, Ministrinë e Financave, INSTAT, Ministrinë për Çështjet e Parlamentit, Ministrin për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Drejtësisë, si edhe SIGMA dhe BE.
- o në takimet e dedikuara **për Demonstrimin e IPSIS** me ministrinë dhe institucionet kryesore (Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Zhvillimit Urban; Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, INSTAT)
- o në një takim të dedikuar, me përfaqësues të **EUD**

Gjatë vitit 2016, u rritën përpjekjet për monitorimin e strategjive. Nga 2 raporte monitorimi të hartuara në vitin 2015, numri i raporteve të monitorimit të strategjive arriti në 5.

Treguesi i Monitorimit të strategjive

24% e raporteve monitoruese për strategjitë e rëndësishme është hartuar dhe publikuar në vitin 2016 krahasuar me 10% në vitin 2015.



Në këtë kuadër të konsoliduar parashikohet se procesi i monitorimit të zbatimit do të bazohet tek monitorimi i SKZHI dhe i strategjive sektoriale/ndërsektoriale. Instrumentet propozues për monitorimin e kuadrit strategjik do të përfshijnë:

- Raportin Vjetor të Progresit të SKZHI të hartuar nga Njësia e Planifikimit Strategjik.
- Raportin Vjetor të Rezultateve të strategjive të hartuara nga Ministritë e Linjës.

Një disa nga sfidat më të cilat vazhdon të ndeshet procesi i monitorimit janë kapacitetet e ministrive të linjës që të sigurojnë një proces cilësor të monitorimit të strategjive, dhe kapaciteteve për hartimin e raporteve në standartet e duhura. Një tjetër sfidë mbetet kapacitetet e limituara humane të Zyrës për Planifikimin Strategjik që të sigurojë orientimin metodologjik në kohë dhe të rishikojnë raportet e paraqitura nga ministritë për të siguruar që janë hartuar sipas standarteve të duhura. Së fundi, një nga sfidat mbetet dhe ndërgjegjësimi i niveleve politike dhe rritja e përgjegjshmërisë në drejtim të arrijës së objektivave të parashikuara në dokumentat strategjike. Informimi i duhur i nivelit politik, prezantimi i sqartë dhe i hapur i problemeve në zbatimin e strategjive, kërkon dhe një ndryshim në kulturën e punës së administratës shqiptare: kulturën e analizës dhe evidentimit të problematikave në mënyrë sa më objektive.

Ka vijuar më tej ngritja e kapaciteteve për planifikimin strategjik dhe aftë sive për planifikimin operacional. ASPA ka organizuar dhe realizuar trajnimin gjithëpërfshirës 14-ditor lidhur me hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe matjen e ndikimit të tyre. Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar 3 programe 14-ditore trajnimi (42 ditë) dhe janë trajnuar 72 NC për kuaderin strategjik dhe 81 NC për Programin Buxhetor Afatmesëm. Në kuadër të kapaciteteve të përmirësuar për planin operacional të punës, janë zhvilluar trajnimin 2-ditor “Kuadri logjik i planifikimit operacional” dhe janë trajnuar 128 Nëpunës Civil nga Ministritë e Linjës.

Aktivitetet prioritare gjatë vitit 2017:

- Miratimi i bazës ligjore dhe metodologjisë së re lidhur me sistemin e monitorimit të strategjive
- Finalizimi i procedurave për operacionalizimin e Sistemit IPSIS
- Ngritja e sistemit të monitorimit të strategjive sektoriale, ngritja e kapaciteteve të ministrive të linjës dhe Njesisë së Planifikimit Strategjik për të realizuar sic duhet procesin e monitorimit.

Risqet kryesore dhe masat zbutëse

Lidhur me zbatimin e prioritetit të parë që lidhet me politikbërjen dhe legjislacionin në kuadër të identifikimit të risqeve konsistohet që risqet mund të lidhen në nivele të brendshme dhe mikro apo sektoriale, megjithatë ekzistojnë disa risqe në nivel planifikimi qendror, politikash dhe koordinimi, madje edhe të një natyre ndër-sektoriale, e cila mund të ketë impakt në realizimin e aktiviteteve dhe rezultateve të dëshirueshme.

Risku identifikues lidhet me kufizimin e kapaciteteve përthithëse, veçanërisht në kuadër të monitorimit të kuadrit strategjik. Në këtë aspekt kemi parashikuar masa të cilat mund të parandalojnë këtë risk identifikues, të cilat lidhen me hartimin e kurrikulave dhe zhvillimin e trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike.


3.1.2. Prioriteti 2: Organizimi dhe funksionimi i administratës publike

Objektivat e planifikuara në kuadër të Prioritetit të II synojnë:


- Fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.
- Ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike.

Kjo fushë përbëhet nga 10 aktivitete, 7 prej të cilave kanë filluar të zbatohen dhe 3 aktivitetet e tjera do të fillojnë të zbatohen në vitin 2017, sic paraqitet në grafikun 6 më poshtë. Nga këto 7 aktivitete të cilat kanë filluar zbatimin, 4 janë realizuar plotësisht deri në 2016 (grafiku 7).

Grafiku 6: Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 7: Statusi i realizimit të nën-aktiviteteve sipas Objektivave



Objektivi 4 "Fuqizimi i strukturave të administratës publike për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për publikun", ka numrin më të madh të nën-aktiviteteve të realizuara plotësisht.

- Progresi kundrejt aktiviteteve

Aktivitetet e planifikuara në kuadër të **Objektivit 4: Fuqizimi i strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut**, janë gjithsej 6 nën-aktivitete prej të cilave 3 kanë nisur të zbatohen dhe janë realizuar plotësisht deri në 2016. Tre nën-aktivitetet e tjera parashikohet të fillojnë zbatimin gjatë vitit 2017.

Fuqizimi i strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut, është një objektivi tejet i rëndësishëm, i cili parashikon fillimisht kryerjen e një studimi për rishikimin e kuadrit ligjor si dhe funksioneve dhe organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës në nivel qendror dhe vendor. Ndërhyrja në strukturat dhe funksionet e institucioneve të varësisë dhe degët e ministrive do të kryhet pas analizimit të gjendjes dhe të faktorëve që influencojnë në aktivitetin e tyre në të ardhmen. Nisur nga rëndësia e aktiviteteve nën këtë Objektivi si dhe mbështetja financiare e nevojshme, ende nuk ka nisur zbatimi i këtyre aktiviteteve për të cilat periodikisht është raportuar se ka boshllëk financiar.

Me qëllim evidentimin e fondeve të nevojshme për nisjen e zbatimit të aktiviteteve të sipërmendura, gjatë vitit 2016, Departamenti i Administratës Publike ka intensifikuar punën për të bërë të mundur fillimin e zbatimit të Projektit IPA 2014, nëpërmjet të cilit synohet të përftohet mbështetja e nevojshme financiare. Fazat për zbatimin e këtij projekti janë drejt finalizimit dhe pritet që projekti të nis zbatimin gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017.

Ndërkohë, Departamenti i Administratës Publike ka punuar për të **bërë të mundur hartimin e një manuali për njësitë e burimeve njerëzore ('HR handbook')**. Tashmë është hartuar drafti i dytë i këtij materiali, i cili do të duhet të kalojë nëpërmjet një rishimi rigoroz për të siguruar cilësinë dhe saktësinë e informacionit e më pas do t'i dërgohet të gjitha institucioneve për komente. Ky draft është hartuar në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit IPA 2012 "Mbështetje për reformën e shërbimit civil në Shqipëri".

Si pjesë e reformës territoriale dhe fuqizimit të bashkive të reja, fokusi ka qënë **të sigurohet mbështetja metodologjike për organizimin dhe funksionimin e njësive të reja administrative të vendit dhe forcim të kapaciteteve zbatuese**. Brenda tremujorit të parë të 2016 me ndihmën e Projektit Star/ PNUD të gjitha bashkitë u pajisën me një model organizimi, i hartuar sipas tipit të bashkisë. Deri në fund të 2016 janë asistuar 30 bashki lidhur me aplikimin e 4 modeleve të organizimit të njësive të reja të propozuara dhe të financuara nga Këshilli i Evropës. Ky proces do të vazhdojë në vitin 2017 në të cilin do të asistohen 20 bashki të tjera. Në kuadër të forcimit të kapaciteteve për menaxhimin e burimeve njerëzore janë trajnuar me Programin e Keshillit të Europës 122 nëpunës civil të pushtetit vendor.

Të katër aktivitetet e planifikuara në kuadër të **Objektivit 5: Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike** kanë filluar të zbatohen dhe është bërë progres i mirë në shumë fusha gjatë 2016.

Progresi i arritur gjatë vitit 2016 konsiston në hartimin e kuadrit të politikave dhe atij ligjor, por dhe përparimi drejt ndërtimit gradual të infrasrukturës së nevojshme të operimit. Është

miratuar Dokumenti i Politikave Afatgjata për Ofrimin e Shërbimeve me në Qendër Qytetarin, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 384 datë 25.05.2016 “Për miratimin e dokumentit të politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri” si dhe është miratuar Ligji nr.13, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

Objektivat e Dokumentit të Politikave Afatgjata për Ofrimin e Shërbimeve me në Qendër Qytetarin synojnë:

1. Reduktimin e kohës dhe barrës administrative për qytetarët dhe bizneset;
2. Përmirësimin e aksesit në shërbime dhe të cilësisë së ofrimit të tyre;
3. Shtimin e numrit të qytetarëve të kënaqur me shërbimet publike;
4. Uljen e korrupsionit, rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në lëvrimin e shërbimeve.

Në zbatim të akteve të sipërpërmendura dhe në përmbushje të aktivitetit 5.1.2 për ngritjen dhe funksionimin e qendrave me një ndalesë, gjatë vitit 2016 janë miratuar 5 VKB/VKM⁹, të cilët i kalojnë ADISA-s të drejtën e administrimit të pronave në kuadër të ngritjes së qendrave me një ndalesë ADISA për ofrimin e shërbimeve publike të integruara, si dhe VKM për miratimin e strukturës dhe të organikës së ADISA

ADISA në nëntor 2016 ka ngritur dhe operon Qendrën e parë të Integruar për Ofrimin e Shërbimeve Publike në Kavajë (qendra e parë me një ndalesë), ku ofrohen shërbimet në sportel të 5 (pesë) institucioneve publike, përkatësisht të ZRPP, FSDKSH, ISSH, DPGJC dhe QKB. Në total ofrohen 206 shërbime, të cilat i përkasin respektivisht institucioneve të lartpërmendura.

Për të mundësuar kalimin e sporteleve pritëse të institucioneve të sipërpërmendura në administrim të ADISA janë miratuar disa aktet ligjore¹⁰. Janë lidhur gjithashtu marrëveshjet e bashkëpunimit

- ⁹ VKB Nr. 10, datë 04.03.2016 “Për dhënie në përdorim nga Bashkia Kavajë, Ministrat të Shtetit për Inovacionin dhe administratën publike, të një sipërfaqe prej 494 m² në katin parë të pronës me emërtimin “Pallati i Kulturës Kavaljon Kavajë” me vendndodhje në Shëtitoren Josif Buda, për vendosjen e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA);
- VKM Nr. 385, datë 25.05.2016 “Për kalimin në përgjegjësi Administrimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të mjediseve të pronës “Ndërtesë Truall me Nr. pasurie 3/703, Lagja Nr. 1 Krujë dhe për një ndryshim të vendimit Nr. 818 datë 06.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”;
- VKM Nr. 306, datë 20.04.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Punëve të Brendshme të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të Katit përdhe të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve” Fier, dhe për një ndryshim në vendimin Nr. 250 datë 24.04.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit publik”, të ndryshuar;
- VKM Nr. 680, datë 28.09.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të ndërtesës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, Gjirokastër, për një ndryshim në Vendimin Nr. 435, datë 16.06.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin “Eqerem Çabej” në Gjirokastër, të pronës nr. 600, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, Gjirokastër dhe për një ndryshim në Vendimin Nr. 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar”.
- VKM Nr. 654, datë 14.9.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ADISA”.
- ¹⁰ VKM Nr. 640, datë 07.09.2016 “Për kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”; VKM Nr. 757, datë 26.10.2016 “Për kalimin e sporteleve pritëse për qytetarët të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”, nëpërmjet të cilit kalohen tek ADISA sportelet pritëse të ZVRPP-ve Kavajë, Krujë, Fier e Gjirokastër;

me Bashkinë Kavajë për vënien në dispozicion të sporteleve pritëse të shërbimit të QKB dhe DPGJC në Qendrën e Integruar Kavajë.¹¹

Miratimi i akteve ligjore të mësipërme ndikon drejtpërdrejt në arritjen e objektivit për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuar, të aksesueshme dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin e etikës në ofrimin e shërbimeve publike. Konkretisht, ngritja dhe funksionimi i Qendrës së parë të Integruar të Shërbimeve Publike në Kavajë jo vetëm përbën arritje në vetvete, por realizon ndarjen e administrimit të sporteleve pritëse të shërbimit të 5 institucioneve (ZRPP, FSDKSH, ISSH, DPGJC dhe QKB) nga zyrat përgjegjëse të shërbimit përkatëse. Administrimi i zyrave pritëse nga ADISA në Qendrën e Integruar Kavajë, po ashtu dhe në sportelet pritëse të ADISA pranë ZVRPP Tiranë shkëput kontaktin mes qytetarit dhe zyrtarëve përgjegjës për lëvrimin e shërbimit, ndërkohë që siguron ofrimin e shërbimeve në sportel për qytetarët në bazë të një modeli të unifikuar në përputhje me standardet e shërbimit ndaj klientit dhe monitorimit të performancës në ofrimin e shërbimeve në sportel duke rritur ndër të tjera transparencën në mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike për qytetarin në sportel.

Vendosja e standardeve të reja të mënyrës së ofrimit të shërbimit ndaj klientit në sportel (si në Zyrën Pritëse të ADISA pranë ZVRPP Tiranë ashtu dhe në Qendrën e Integruar Kavajë) rezultojnë të kenë përmirësuar ndjeshëm mënyrën e menaxhimit të rradhës së pritjes për marrjen e shërbimit, duke e reduktuar atë. Perceptimi i qytetarëve për cilësinë e mënyrës së marrjes së shërbimit si në Zyrën Pritëse ADISA pranë ZVRPP Tiranë, ashtu dhe në Qendrën e Integruar Kavajë rezulton të jetë pozitiv bazuar në anketimet e vazhdueshme të kryera nga ADISA për matjen e opinionit të qytetarëve. Më konkretisht, qytetarët shprehen se marrin informacionin e duhur në sportelet info-point, janë të kënaqur me ambientet e pritjes, me respektimin e rradhës, me procesin e aplikimit dhe me sjelljen e sportelistëve në Zyrat Pritëse të ADISA.

Në vitin 2016, ADISA, në përputhje me Objektivin e Planit Operacional të MSHIAP për vitin 2016-2017 për ngritjen e 3 (tre) Qendrave të Integruara për Ofrimin e Shërbimeve Publike (Krujë, Fier Gjirokastër) ka vijuar gjithashtu punën për ngritjen e Qendrave të Integruara Krujë, Fier e Gjirokastër, për të cilat janë zhvilluar procedurat përkatëse të prokurimit për rikonstruksionin e godinave. Rikonstruksioni i godinës së Qendrës të Integruar Krujë ka përfunduar, çelja e së cilës planifikohet të realizohet në muajin mars 2017, ndërkohë që rikonstruksioni i godinave të Qendrave të Integruara Fier e Gjirokastër vazhdon.

Gjatë periudhës mars-shtator 2016 është punuar dhe ka përfunduar për Studimin e Fizibilitetit për Ndarjen e Zyrave Pritëse (FO) nga Zyrat e Përgjegjëse të Ofritit të Shërbimit (BO). Studimi i Fizibilitetit përmban një analizë të gjendjes aktuale të shpërndarjes së shërbimeve në Shqipëri si dhe parashtrohet disa skenarë të një shpërndarjeje më efektive të degëve të ADISA në territorin shqiptar, të cilat do të ofrojnë informacion dhe mundësi aplikimi për rreth 500 shërbime publike të ofruara nga 12 institucione publike.


- Kontrata Administrative dt.09.11.2016, lidhur ndërmjet ADISA (nr.1274) dhe ISSH (nr.9009), për kalimin e sporteleve pritëse të shërbimit të ISSH tek ADISA;

¹¹ Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Kavajë nr.2623 dt.26.09.2016 dhe ADISA nr.1044 dt.27.09.2016 për vënien në dispozicion të 3 (tre) sporteleve pritëse të shërbimit të QKB-së;

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Kavajë nr.2623/1 dt.26.09.2016 dhe ADISA nr.1044/1 dt.27.09.2016 për vënien në dispozicion të 4 (katër) sporteleve pritëse të shërbimit të DPGJC-së.

Treguesi : Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes

Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2017¹² janë tejkaluar në nivelin 37.3%.



Në vitin 2015, numri i shërbimeve të ofruara në zyrat e përmirësuara të pritjes ishte 51. Këtu përfshihet numri i shërbimeve të ZVRPP Tiranë të ofruara nga ADISA në sportelet pritëse.

Në vitin 2016, numri i shërbimeve të ofruara arrin vlerën 206 ku përfshihen: 52 shërbime të ZVRPP Tiranë dhe Kavajë, 1 shërbim të FSDKSH, 67 shërbime të ISSH, 64 shërbime të QKB dhe 22 shërbime të DPGJC.

Deri në fund të 2016 është kryer pilotimi për sportelet unike në institucionet e pushtetit vendor dhe po tenderohet projekti për pjesën tjetër të bashkive dhe shtrirjen e projektit në të gjithë territorin. Afati i parashikuar i zbatimit të këtij projekti është 3-mujori IV 2017 me një kosto prej 2 milion \$ e cila është mbuluar nga Projekti Star/ PNUD.

Treguesi i sporteleve unike arriti në 5 sportele të krijuara në institucionet e pushtetit vendor deri në fund të vitit 2015 (faza pilot). Ky tregues mbetet i pandryshuar për vitin 2016. Shtrirja e sporteleve unike në të gjithë territorin pritet të përfundojë në fund të 2017.

- Hapat e ardhshëm për zbatimin në kohën e duhur të aktiviteteve

- Ristrukturimi i ADISA-s për të akomoduar ndryshimet që do të vijnë si pasojë e çeljes/shtimit së/të Qendrave të Integruara.

- Aktivitetet prioritare gjatë vitit 2017

- Hapja e qendrave të përqendruara të ofrimit të shërbimeve publike në Krujë, Fier dhe Gjirokastrë, si dhe një Qendër e katërt me lokacion ende të papërcaktuar.
- Shtrirja e sporteleve unike edhe në bashkitë e tjera bazuar në modelin e përzgjedhur.

¹² Niveli i ri i synuar për vitin 2017 është 150 (referuar Pasaporta e Indikatorëve, fq. 15).

Risqet kryesore dhe masat zbutëse

Sfidat që hasen në përmbushje të objektivit për ngritjen e Qendrave të Integruara ADISA lidhen së pari me gjetjen e lokacioneve të përshtatshme për ngritjen e tyre, si dhe me ngritjen e një sistemi të monitorimit të proceseve të punës e të mënyrës së ofrimit të shërbimeve në to. Adresimi i kësaj sfide qëndron në ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit për të gjitha Qendrat e Integruara ADISA që planifikohen të jenë operative.

3.1.3. Prioriteti III Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore


Objektivat e parashikuara brenda këtij prioriteti synojnë:

- *Përmirësimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim*
- *Organizimin e sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme*


Siç paraqitet edhe në grafikët më poshtë në kuadër të këtij prioriteti janë parashikuar të realizohen 25 aktivitete, prej të cilëve kanë filluar të zbatohen 17 dhe 8 aktivitete të tjera do të fillojnë të zbatohen pas vitit 2016.

Nga 17 aktivitetet e filluara deri në fund të 2016, janë realizuar plotësisht 9 aktivitete dhe 8 të tjera janë realizuar pjesërisht.

Graph 9 : Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas Objektivave



Graph 10: Statusi i realizimit të nën-aktiviteteve sipas Objektivave



Progresi i arritur në zbatimin e aktiviteteve

Objektivi 6: Kapacitete të përmirësuara për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim ka edhe numrin më të madh të aktiviteteve të parashikuara në strategji në raport me objektivat e tjerë, 22 aktivitete nga të cilat 17 kanë filluar të zbatohen në deri në fund të 2016, ndërsa 5 të tjera parashikohen të fillojnë në vitin 2017. Ndër këto aktivitete 9 prej tyre janë realizuar plotësisht. Më poshtë paraqiten arritjet konkrete kundrejt objektivave të përgjithshëm të cilët synojnë përmirësimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil.

Janë hedhur hapa të mëtjshëm në drejtim të vlerësimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1037, datë 16.12.2015 *“Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”*, detajon procesin e përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë duke synuar aftësimin e nëpunësve civilë dhe pajisjen e tyre me njohuritë shtesë të nevojshme, sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të punës në institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil. Ky proces përfshin testimin paraprak dhe, kur është e nevojshme, trajnimin e nëpunësve civilë për njohuritë e reja që prekin fushën e tyre.

Gjatë vitit 2016, u organizuan dy procedurat e para të testimit për nëpunësit civil ekzistues në Njësitë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Njësitë e Rrjetit të Integritetit Evropian. Pas kësaj eksperience të aplikuar për herë të parë, u evidentuan pikat e dobëta dhe të forta të mënyrës së implementimit të këtij vendimi dhe u propozuan një sërë ndryshimesh me qëllim përmirësimin e mëtjshëm të këtij procesi të rëndësishëm. Kështu, u përgatitën disa propozime për të përmirësuar procedurën duke synuar një planifikim dhe menaxhimin të mirëpërcaktuar të të gjithë procesit, bazuar mbi eksperiencën e nxjerrë.

Janë forcuar më tej kapacitetet e DAP për të udhëhequr strategjikisht reformën në shërbimin civil. Pas analizës funksionale të bërë në lidhje me përgjegjësitë e reja të DAP në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil por edhe në zbatimin e SNRAP 2015-2020, doli e nevojshme fuqizimi i strukturës së DAP duke rritur numrin e punonjësve në dispozicion të Departamentit me qëllim përballimin me sukses të këtyre objektivave; më konkrekt organika e DAP u shtua me 10 pozicione duke e çuar numrin e pozicioneve të punës në DAP nga 43 që ishte në vitin 2015 në 53 në vitin 2016. Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të ligjit mbi integritetin, struktura e DAP do të përfshijë një njësi të dedikuar për menaxhimin e këtij procesi.

Me qëllim përmirësimin e mëtjshëm të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil dhe modernizimin e procesit, Departamenti i Administratës Publike ka punuar në disa drejtime:

Me qëllim rritjen e mëtjshmë të transparencës dhe zbatimin e mekanizma për vlerësimin objektiv të kandidatëve, tezat e testimit për procedurat e rekrutimit të organizuara gjatë vitit 2016, janë gjeneruar dhe korigjuar automatikisht nëpërmjet sistemit elektronik, në bazë të fushës së njohurive për secilën procedurë

Ndërkohë, gjatë vitit 2016, Departamenti i Administratës Publike është fokusuar në pasurimin dhe përmirësimin e mëtjshëm të bankës së pyetjeve, nëpërmjet së cilës tezat e testimit gjenerohen automatikisht në bazë të fushës përkatëse të njohurive. Për këtë arsye, falë mbështetjes të Këshillit të Evropës, nisi puna për pasurimin e bankës së pyetjeve në bashkëpunim me ekspert të fushës. Fillimisht, u bë ri-shikimi dhe ri-formulimi i të gjitha pyetjeve të përdorura në procedurat e

rekrutimit të zhvilluara gjatë vitit 2015, për t'i përshtatur me formatin që kërkon sistemit elektronik. Ekspertët kanë përgatitur grupin e parë të pyetjeve për disiplina të ndryshme. Këto pyetje do të duhet të kalojnë nëpërmjet një filtrimi final për të siguruar përputhshmërinë e tyre me fushat e njohurive për procedura e planifikuara të rekrutimit për vitin 2017, qartësinë në formulimin e pyetjeve duke shmangur maksimalisht keq-interpretimin e tyre, referencën e përditësuar ligjore si dhe çdo element tjetër të rëndësishëm për të siguruar saktësinë e tyre. Më pas, të gjitha këto pyetje, do t'i shtohen bankës ekzistuese duke rritur kështu ndjeshëm numrin e pyetjeve për secilën fushë dhe duke kontribuar drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe profesionalizmit në organizimin e procedura të rekrutimit.

Treguesi: “Numri mesatar i pjesëmarrësve në një procedurë rekrutimi për rekrutim nga jashtë dhe nga brenda (transferimi) në shërbimin civil”.

Ky tregues matet nëpërmjet dy nën-treguesve, respektivisht:

1: Numri mesatar i pjesëmarrësve nga jashtë shërbimit civil që marrin pjesë në një procedurë rekrutimi. Ky tregues për vitin 2016 ka qenë 10. Vërejmë një tendencë në ulje të këtij indikator që në vitin 2015 ka qenë 13.1. Ky indikator është matur duke përlogaritur numrin total të kandidatëve të kualifikuar të cilët kanë aplikuar për një pozicion ekzekutiv (niveli specialist) i cili ka qenë 8470 për vitin 2016, ndërsa numri i pozicioneve të shpallura: 858 pozicione.

2 Numri mesatar i pjesëmarrësve brenda shërbimit civil që marrin pjesë në një proces rekrutimi. Ky tregues për vitin 2016 ka qenë 1.67. Vërejmë një tendencë në rritje të këtij indikator që në vitin 2015 ka qenë 1.3. Numri i aplikantëve brenda shërbimit civil, në të treja kategoritë, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë është 1428. Numri i pozicioneve të shpallura për të cilat ka pasur aplikime brenda sistemit të shërbimit civil, në të treja kategoritë, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë është 857.

Sa i takon përfshirjes së pyetjeve të integriteti në për testimin hyrës në shërbimin civil, gjatë vitit 2016, Departamenti i Administratës Publike në bashkepunim me zyrën e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore/ Koordinator Kombëtar për anti-korrupsionin punoi ngushtë me ekspertizën e ofruar nëpërmjet Projektit të Binjakëzimit, për të gjetur qasjen dhe mënyrën më të përshtatshme për të përfshirë këto tipologji pyetjesh në testimet hyrëse. Me qëllim që të sigurohet metoda më e drejtë për vlerësimin e përgjigjeve të këtyre pyetjeve, stafi i rekrutimit të DAP, u trajnuar për metodat e vlerësimit të përgjigjeve, elementët që duhet të mbahen në konsideratë për të bërë një vlerësim të drejtë e shumë detaje të tjera, specifike për këtë fushë. Fillimisht, planifikohet përfshirja e këtyre pyetjeve të integriteti në formën e një ‘pilotimi’ për të parë reagimin e kandidatëve ndaj një qasje të re dhe për të bërë përshtatjet e nevojshme. Përfshirja e këtyre lloj pyetjesh bën të mundur testimin e elementëve që lidhen me ndershmërinë dhe integritetin e individëve, të cilët punësohen në sektorin publik si parakusht për parandalimin e korrupsionit.

Të gjitha këto masa synojnë të sigurojnë paanshmërinë dhe garantimin e një procesi rekrutimi transparent, të paanshëm dhe meritokratik.

Numri i ankesave lidhur me rekrutimin në shërbimin civil të pranuar nga gjykata për vitin 2016 ka qenë 1 rast.

Në kuadër të angazhimit për thjeshtimin dhe formatimin e hapave dhe proceseve që lidhen me burimet njerëzore të administratës publike, DAP është duke punuar për hartimin e Termave të Referencës, për ekspertët që do të përfshihen në këtë proces, me mbështetjen financiare të Bashkimit European.

Qarkullimi vjetor i stafit të nivelit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore për 2016 ka qënë në nivelin 5.4%.¹³ Numri total i lirimeve në nivel drejtues ka qënë 98 dhe numri total i stafit drejtues në fillim të vitit ka qënë 1812, ose 5.4% Synimi është që ky tregues të ketë një tendencë në rënie. Në krahasim me vitin 2015 (vlera 6.8%) vërejmë një tendencë në rënie të vlerës së këtij Indikatori.

Grupi i indikatorëve për monitorimin e reformës në shërbimin civil dhe publikimin periodik të tyre u hartua dhe publikua. Me mbështetjen e ekspertizës së mundësuar nga Projekti i Binjakëzimit IPA 2012, gjatë vitit 2016 u punua për finalizimin e indikatorëve. Fillimisht u hartua një set i gjerë indikatorësh të cilët kaluan nëpërmjet një fazë vlerësimi për të përzgjedhur ata indikatorë që do të përfshihen në raportimet periodike të DAP. Indikatorët e përzgjedhur, janë përfshirë në Raportin Vjetor të përgatitur nga DAP dhe janë lehtësisht të identifikueshëm nëpërmjet një formatimi të posacëm. Në secilin prej pjesëve të raportit, krahas përshkrimit narrative dhe të dhënave të tjera të përgatitura, janë evidentuar edhe indikatorët. Raporti dhe indikatorët do të jenë të aksesueshëm për publikun në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e transparencës ndaj tij.

Gjatë vitit 2016 puna për plotësimin me informacion dhe shtrirjen e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) në institucionet e administratës publike u fokusua në plotësimin e informacionit përse i përket strukturave dhe organikave të të gjitha institucioneve që janë pjesë e shërbimit civil, duke bërë të mundur që të hidhen në sistem mbi 330 njësi shpenzuese pjesë të shërbimit civil. Për këto njësi shpenzuese është hedhur në sistem informacioni për mbi 11000 të punësuar (krahasimisht me 6000 deri në fund të vitit 2015). Tashmë janë përfshirë në SMIBNj, të gjitha strukturat/organigramat e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil dhe ka nisur puna për përfshirjen e njësive të qeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura.

Progres është arritur në drejtim të zhvillimi të HRMIS duke përfshirë funksionin e përlllogaritjes së pagave bazuar në skemat dhe kategorite e tyre. Moduli i pagave të HRMIS do të bëjë të mundur jo vetëm gjenerimin automatik të pagave duke siguruar një saktësi më të lartë cilësie të informacionit, por gjithashtu do të ndikojë drejtëpërdrejtë në përditësimin e dosjes së cdo punonjësi, duke garantuar kështu një sistem elektronik jo vetëm funksional, por edhe një sistem i cili reflekton informacionin më të fundit për cdo punonjës.

Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave, ka punuar për unifikimin e borderosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme me qëllim që të bëhet e mundur konsolidimi i modulit të pagave të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS). Falë këtij bashkëpunimi, në Dhjetor të vitit 2016 u nënshkrua Udhëzimi i përbashkët mes Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe

¹³ Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar numrin e stafit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore që janë larguar (ose hequr) nga pozicionet e tyre në një vit/pjesëtuar me numrin total të stafit drejtues në administratën qendrore në vitin e dhënë.

Ministrit të Financave (Udhëzimi nr.4, datë 13.12.2016) “Për formën, elementët dhe plotësimin e borderosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (të gjitha institucionet publike).

Bazuar në këtë dokument ka filluar të implementohet zgjidhja në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS), përmes së cilës do të bëhet e mundur që të gjenerohet automatikisht formati i ri i borderosë së pagave.

Kjo nënkupton përdorimin e një formati të unifikuar të borderosë i cili do të përdoret nga të gjitha institucionet shtetërore. Hapi tjetër është përdorimi i modulit të pagave përmes HRMIS nga institucionet i cili do të bëjë të mundur gjenerimin automatik të listepagesave për çdo institucion në bazë të informacionit prezent në HRMIS.

Bazuar në Udhëzimin të përbashkët, gjenerimi i borderosë nëpërmjet HRMIS do të fillojë të implementohet çdo muaj për grupe institucionesh deri në arritjen e gjenerimit të borderosë nëpërmjet HRMIS për të gjithë. Për të mundësuar zbatimin e tij, do të ndiqet fillimisht plani i trajnimit për nëpunësit në njësitë e financës në institucionet e administratës publike dhe më pas plani testimeve për institucionet do të prodhojnë borderonë e pagës nëpërmjet HRMIS.

Për sa i takon trajnimit të nëpunësve për përdorimin e Sistemit, ka përfunduar trajnini i përfaqësuesve të burimeve njerëzore, të të gjitha institucioneve qëndrore dhe varësisë së tyre, pjesë e shërbimit civil. Ndërkohë, gjatë vitit 2016, janë bërë trajnimet përkatëse për njësitë e qeverisjes vendore dhe kanë nisur trajnimet me institucionet e pavarura. Gjatë vitit 2016 janë trajnuar mbi 200 nëpunës të sektorëve të burimeve njerëzore përfshirë këtu edhe institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke zhvilluar mbi 25 seanca trajnimi të fokusuara për strukturat, organikat dhe hedhjen e të dhënave të dosjes individuale të të punësuarve.

Zbatimi i planit të trajnimit 2016 në kuadër të Strategjisë RAP, i hartuar në përputhje me nevojat për trajnim është realizuar plotësisht. Gjatë vitit 2016 me fonde të buxhetit të shtetit janë zhvilluar 726 ditë trajnimi dhe trajnuar 4650 NC.

Në kuadër të projektit të Binjakëzimit po rishikohen kurrikulat e trajnimit pjesë e **trajnimit të vazhduar**. ASPA ka hartuar programet gjithëpërfshirëse “Planifikimi Strategjik”, “Menaxhimi i Financave Publike”, “Prokurimi Publik” dhe është në procesin e hartimit të programit gjithëpërfshirës “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”. Në vitin 2016 u hartua program i trajnimit për Nivelin e Lartë Drejtues.

Niveli i kënaqësisë së pjesëmarrësve në kurset e trajnimit për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues është në masën 70%. Gjatë vitit 2016 u realizua matja e ndikimit të trajnimit nga niveli i mesëm dhe i lartë drejtues e realizuar 70% pranojnë që trajnimet ndihmojnë në rritjen e performancës.

Platforma e-learnig e zhvilluar nga ASPA ka funksionuar si pjesë e zhvillimit të trajnimit. Gjatë vitit 2016 kanë ndjekur të paktën një modul trajnimi 745 NC.

Realizimi i bibliotekës në formatin e-library, është në fazën përfundimtare. Gjatë vitit 2016 ASPA me mbështetjen e projektit DLDP janë realizuar:

- Përcaktimi i standerteve të cilësisë së kurrikulave të trajnimit
- Hartimi i metodologjisë për Sigurimin e Cilësisë së Kurrikulave
- Zhvillimi i platformës e-library

Vlerësimi i cilësisë së trajnimit është realizuar vazhdimisht dhe për vitin 2016 kemi këto tregues (në një shkallë 1 deri 6)

- Vlerësimi mesatar i kurseve të trajnimit 5.37
- Vlerësimi në organizimin e kurseve 5.56

Kutia 2: Metodat e Matjes së Përformancës

Përcaktimi i kënaqësisë së klientit (në këtë rast administratës publike) do të përcaktohet nëpërmjet:

- Përdorimit të formularëve të matjes së reagimit të pjesëmarrësve pas trajnimit;
- Përdorimit të formularëve të matjes së ndikimit të trajnimit pas një periudhe 6 – 12 mujore (formularë të vetvlerësimit);
- Përdorimit të formularëve të matjes së ndikimit të trajnimit pas një periudhe 6 – 12 mujore (formularë për eprorin direkt);
- Studimit dhe përpunimit të formularëve të vlerësimit të arritjeve individuale (pjesës së trajnimit) në punë të nëpunësit civil (çdo vit);
- Marrjes së informacionit nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të çdo institucioni;

Një nga treguesit cilësor të matjes së arritjeve të ASPA është treguesi i Kënaqësisë së Klientit (*customer satisfaction*). Ky indikator është mjaft i rëndësishëm për të vlerësuar pas një periudhe kohore se sa, programet e trajnimit, të ofruara nga ASPA, janë efektive, në përshtatje me nevojat reale dhe kanë ndihmuar në rritjen e performancës së administratës publike.

Ky tregues shërben në përmirësimin e kurrikulave të trajnimit, mundësinë e ofrimit të metodologjive inovative në zhvillimin e trajnimit si dhe ruajtjen dhe rritjen e imazhit të ASPA si një qendër për zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale.

Ndërkohë në vitin 2016 vazhdon procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit “Për nëpunësin civil”. Nisur nga situata e konstatuar gjatë mbikëqyrjes, si dhe nga komunikimi i vazhdueshëm me institucionet që veprojnë në fushën e shërbimit civil, Komisioneri e vlerëson në një nivel të mirë zbatimin e ligjit nr. 152/2012, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Komisioneri vlerëson nivelin në ngritje të punës së Departamentit të Administratës Publike në aspekte të ndryshme të administrimit të shërbimit civil. Duke u mbështetur në përfundimet e nxjerra gjatë mbikëqyrjes së procesit të rekrutimit, të kryer pranë Departamentit të Administratës Publike, Komisioneri ka konstatuar se ky institucion vijon të punojë me ritme të larta, për ta vendosur procesin në korniza të rregullta procedurale. Edhe gjatë këtij viti, konkurrimet vijnë të zhvillohen në grup dhe me një numër të konsiderueshëm kandidatësh që siguron një prag të kënaqshëm cilësie të pjesëmarrësve në proces.

Gjatë këtij viti, konstatohen tendenca të rritjes së nivelit të zbatimit të institutit të rekrutimit në grup edhe në institucionet e administratës vendore dhe institucioneve të pavarura, të cilat një vit më parë kanë qenë problematike në këtë drejtim.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KSHMC) ka mbikëqyrur **40** institucione, nga të cilat **33** i përkasin administratës shtetërore (**2** ministri dhe **31** institucione varësie) dhe **7** njësi të qeverisjes vendore (ku përfshihen 7 bashki dhe **43** njësi administrative (ish-komuna), të cilat i janë bashkëngjitur bashkive me ndarjen e re administrativo-territoriale), që në total përfshijnë **2233** pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Kanë përfunduar me vendim paralajmërimi për rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil **26** procedura mbikëqyrje/inspektime të përgjithshme nga të cilat **22** i përkasin administratës shtetërore dhe **4** njësive të qeverisjes vendore (bashki), ku Komisioneri ka paraqitur rekomandimet për rregullimet përkatëse ligjore që duhet të ndërmerren nga institucionet e mbikëqyruara në lidhje me administrimin e shërbimit civil:

- Në **300 raste** është kërkuar të bëhet anulimi (revokimi) i akteve administrative për emërimet të kryera në kundërshtim me ligjin (kontratë apo akt emërimi i përkohshëm);
- Në **483 raste** është kërkuar anulimi (revokimi), ndryshimi apo nxjerrja e akteve administrative për deklarimin e statusit të punësimit.

Ndërkohë janë në proces **14** procedura mbikëqyrje/inspektime të përgjithshme nga të cilat **11** i përkasin administratës shtetërore (Dr. Bujqësisë Berat, Fier, Durrës, Elbasan, Lushnjë, Prefekti Berat, Dibër, Fier, Gjirokastrë, Elbasan, dhe ISUV), dhe **3** njësive të qeverisjes vendore (Bashkia Elbasan, Shkodër dhe Pukë).

1. Kanë ardhur **90** informacione/ankesa nga të cilat **56** i përkasin administratës shtetërore, **32** njësive të qeverisjes vendore dhe **2** institucioneve të pavarura.
2. Është kryer procesi i mbikëqyrjes/inspektimit të orientuar për **89** procedura pranimi në shërbimin civil në nivel ekzekutiv pranë Departamentit të Administratës Publike.
3. Gjatë vitit 2017, do të vazhdojë trajtimi i mëtejshëm i proceseve të iniciuara gjatë vitit 2016, si dhe do të vijohet me mbikëqyrjet/inspektimet e planifikuara në Planin Vjetor të Punës 2017.

Një nga objektivat më të rëndësishme të reformes së shërbimit civil dhe vetë Strategjisë është ai i **Organizimit të sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme (Objektivi 7).**

Me qëllim realizimin e masave të parashikuara për këtë Objektiv, po punohet për finalizimin e termave të referencës me qëllim finalizimin e hapave të nevojshëm për nisjen e zbatimit të Projektit IPA 2014.

Të dy treguesit që lidhen me politikat e pagave nuk kanë pësuar ndryshime në vitin 2015:

Raportit ndërmjet pagës maksimale dhe pagës minimale në vitin 2016 mbetet i pandryshuar, në nivelin 11.7%.

Ndryshime të skemës dhe numrit të pozicioneve në skemën e pagave mbështetur në përmbatjen e përshkrimit të punës = 0

Të dy treguesit e mësipërm lidhen me realizimet e tre aktiviteteve të renditura më lartë.

- Hapat e ardhshëm për zbatimin në kohën e duhur

Për zbatimin në kohën e duhur rekomandohen hapat e ardhshëm:

- Ri-shikimi i planit të aktiviteve, parashikuar për t'u zbatuar për periudhën 2018-2020, duke vlerësuar edhe nevojat financiare për zbatimin e strategjisë për trevjeçarin e ardhshëm me qëllim përcaktimin e aktiviteteve me afate reale dhe të arritshëm;

- Finalizimi i proceseve të nevojshme për të bërë të mundur implementimin e projektit IPA 2014, duke synuar kështu nisjen e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në të;
- Bashkëpunimi e vazhdueshëm ndërinstitucional si një elementë kyç për zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve;
- Raportim periodik dhe monitorim i ecursisë së aktiviteteve me qëllim evidentimin në kohë të sfidave apo pengesave të mundëshme të cilat mund të ndikojnë në zbatimin brenda afatit kohorë të përcaktuar.

- Aktivitetet prioritare gjatë vitit 2017

- ✓ *Rritjen e cilësisë së procesit të rekrutimit në shërbimin civil, nëpërmjet:*
 - përmirësimit të procesit të planifikimit të vendeve vakante dhe plotësimit të nevojave për rekrutim, duke bërë një grupim më të mirë të pozicioneve të kategorisë ekzekutive;
 - transformimit të faqes zyrtare të DAP në një portal për të gjithë administratën publike, ku informacioni të jetë i thjeshtë për t'u aksesuar dhe i lehtë për t'u kuptuar nga të gjithë, qofshin këta qytetarë, nëpunës civilë apo kandidatë potencialë
 - përmirësimit, pasurimit dhe përditësimit të përmbajtjes së bankës së pyetjeve në përputhje me kërkesat e procesit të rekrutimit;
 - përdorimit të pyetjeve që vlerësojnë integritetin e kandidatëve, duke bërë pjesë të procesit të përzgjedhjes testimin e elementëve që lidhen me ndershmërinë dhe integritetin e individëve, të cilët punësohen në sektorin publik si parakusht për parandalimin e korrupsionit
 - trajnimit të anëtarëve të Komiteteve të Përhershme të Pranimi mbi metodologjinë dhe teknikat më të mira të vlerësimit;
 - bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë me qëllim informimin e kandidatëve potencialë (studentët dhe të sapodiplomuarit) lidhur me mundësitë e punësimit në administratën shtetërore, etj
 - përgatitjen e një sërë materialesh orientuese për t'i ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve potencialë (video-tutorial mbi mënyrën e aplikimit, dokument shpjegues mbi pyetjet më të shpeshta);
- ***Forcimin e kapaciteteve të DAP dhe njësive të burimeve njerëzore në institucionet e administratës shtetërore***
- ***Vlerësimin e performancës së nëpunësve civilë si dhe të kapaciteteve ekzistuese nëpërmjet përcaktimit të objektivave të qartë dhe një seti indikatorësh për matjen e tyre, duke u fokusuar edhe në trajnimin e vazhdueshëm të zyrtarëve përgjegjës për kryerjen e këtij procesi;***
- ***Zhvillimi i mëtejshëm i metodave inovative për të përmirësuar dhe lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes institucioneve publike dhe qytetarëve***
- ***Zhvillimi dhe vënia në funksionim e Regjistrit Qëndror të Personelit (HRMIS/SIMBNJ). Zgjerimi i ndërveprimit të sistemit HRMIS me të tjera baza të dhënash dhe sisteme të rëndësishme shtetërore si dhe shtrirja e mëtejshme e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ/HRMIS) në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Implementimi i modulit të pagave nëpërmjet SIMBNJ/HRMIS për të paktën 30% të institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil***

- **Forcimi i vazhdueshëm i ASPA si ofrues i trajnimeve për shërbimin civil.** Rritja e cilësisë së trajnimeve të ofruara, dhe zhvillimi i një metodologjies trajnime me qasje inovative nëpërmjet platformave e-learning dhe e-training.

Sfidat për vitin 2017

Përpos arritjeve në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim, gjatë vitit 2017 në fokus do të jetë vazhdimi i implementimit të reformave në këtë fushë me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të të gjithë proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore:

- Zbatimi i masave të parashikuara në Planin e Veprimit për vitin 2015-2017, ri-shikimi i tij në përputhje me eksperiencën e deritanishme dhe përcaktimi i aktiviteteve konkrete dhe të arritshëm. Vlerësimi i nevojave financiare për zbatimin e strategjisë i orientuar në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm
- Nisja e zbatimit të Projektit IPA 2014, nëpërmjet të cilit synohet përmbushja e disa aktiviteteve të rëndësishme për të cilat ka patur boshllëk financiare duke ndikuar kështu në implementimin e tyre;

3.1.4. Prioriteti IV - Procedurat administrative dhe mbikëqyrja



Reformat e parashikuara nën fushën prioritare **“Procedurat administrative dhe mbikëqyrja”** do të orientohen drejt arritjes së katër objektivave të mëposhtme:

- *Zbatimin e procedurave të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin*
- *Zhvillimin e një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit*
- *Rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë*
- *Rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.*

Kjo shtyllë përmban 17 aktivitete nga të cilat 15 kanë filluar zbatimin. Krahasuar me prioritetet tjera, ky prioritet ka shkallën më të lartë të aktiviteteve që janë realizuar krahasuar me tre shtyllat e tjera prioritare. Nga aktivitetet të cilat kanë filluar të zbatohen janë realizuar plotësisht 10 deri në fund të 2016.

Graph 11 : Numri aktiviteteve në zbatim

Graph 12: Shkalla e realizimit të aktiviteteve



- Progresi kundrejt aktiviteteve

Në kuadër të **Objektivit 8: "Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin"** janë parashikuar gjithsej 7 aktivitete të cilat kanë filluar zbatimin deri në fund të 2016. Nga këto 7 aktivitete 4 janë realizuar plotësisht.

Në muajin janar 2016 u nënshkrua kontrata për projektin e ri-inxhinierimit, duke përfshirë riinxhinierimin e aspektit të procedurave për ofrimin e shërbimit publik, atë ligjor dhe IT, nga 10¹⁴ institucione qendrore në vend, në fokus të projektit.

Institucioni	Numri i shërbimeve
Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	5
Qendra Kombëtare e Biznesit (Qendra Kombëtare e Licencimit + Qendra Kombëtare e Regjistrimit)	169
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	52
Agjencia e Zhvillimit të Territorit	12
Instituti i Sigurimeve Shoqërore	67
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	64
Drejtoria e Përgjithshme Detare	18
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	1
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	22
Ministria e Arsimit dhe Sportit	11

¹⁴ Fillimisht objekt riinxhinierimi kanë qenë 11 institucione. Për shkak të bashkimit në një të QKR dhe QKL gjatë 2016 dhe krijimit të QKB, institucionet rezultojnë të jenë 10.

Është hartuar një metodologji e plotë për realizimin e procesit të ri-inxhinierimit, e cila do të drejtojë ADISA-n edhe në projektet e ardhshme të përmirësimit të proceseve të shërbimeve publike. Kjo metodologji është miratuar në takimin e Komitetit Ndërmintor për Shërbimet Publike, zhvilluar me datë 8 Nëntor 2016.

Ka përfunduar validimi i proceseve të marrjes së shërbimit nëpërmjet krijimit të hartave “Baseline/AS-IS” për institucionet në fokus. Është trajnuar po ashtu ekipi i ADISA-s përgjegjës për ri-inxhinierimin, si dhe ekspertë të ADISA nga sektori juridik, sektori i shërbimeve, sektori i standardeve dhe ankesave. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë trajnuar grupet teknike të punës pranë 10 institucione në fokus mbi teknikat e ri-inxhinierimit.

Gjatë vitit 2016 është punuar për përgatitjen e hartave TO-BE të proceseve të punës për marrjen e shërbimeve. ADISA, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për hartimin e modeleve¹⁵ po ashtu ka thjeshtuar mënyrën e marrjes së informacionit për përfitimin e shërbimeve publike duke përgatitur modelin unik të Kartelës Informative të shërbimeve publike e duke hartuar 481 Kartela Informative për shërbimet e 18 (tetëmbëdhjetë) institucioneve të administratës shtetërore.¹⁶

Ndër to, 420 Kartela Informative janë validuar nga 10 (dhjetë) prej institucioneve të sipërpërmendura¹⁷, duke përcaktuar kështu mënyrën e marrjes së shërbimeve publike që ofrohen prej tyre dhe dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e tyre, ndërsa 61 Kartela Informative të tjera i janë dërguar 8 (8) institucioneve përkatëse¹⁸ për validim.

420 Kartelat Informative të validuara janë hedhur gjithashtu në databazën e shërbimeve publike, e cila administrohet nga ADISA. ADISA në bashkëpunim me AKSHI-n ka standardizuar gjithashtu mënyrën e marrjes së informacionit për përfitimin e shërbimeve publike në platformën qeveritare e-Albania duke vendosur në dispozicion të AKSHI-t Kartelat Informative të validuara për 420 shërbime.

Nga tetori 2016 qytetarët informohen në bazë të 420 Kartelave Informative për mënyrën e përfitimit të 420 shërbimeve të 10 institucioneve (si më sipër) edhe nëpërmjet Call Center ADISA, i cili operon nga e hëna në të shtunë nga ora 8:00 deri në orën 21:00. Për periudhën tetor-dhjetor 2016 rezultojnë të informuar 2257 qytetarë nëpërmjet shërbimit të Call Center, ndërsa institucionet më të kërkuara janë si më poshtë:

- ✓ **Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;**
- ✓ *Drejtoria e Përgjithshme Shtetërore e Transportit Rrugor;*
- ✓ *Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.*

Shërbimet për të cilat kërkohet më së shumti informacion nga ana tjetër janë:

- 1. Aplikim për pasaportë biometrike (DPGJC);**
- 2. Rinovimi i lejedrejtimit (DPSHTRR);**
- 3. Rivlerësim i pasurisë së paluajtshme (ZRPP).**

¹⁵ Bazuar në VKM Nr. 343 datë 04.05.2016 “Për përcaktimin e autotetitit përgjegjës për hartimin e modeleve”.


¹⁶ AQTN, AZHT, DPD, DPGJC, DPSHTR, FSDKSH, ISSH, QKB, MAS, ZRPP, ATP, AKP, DPP, DPB, SSSH, ALUIZNI, ABSA dhe DPT,

¹⁷ Nga AQTN, AZHT, DPD, DPGJC, DPSHTRR, FSDKSH, ISSH, QKB, MAS, ZRPP.

¹⁸ Përkatësisht ATP, AKP, DPP, DPB, SSSH, ALUIZNI, ABSA dhe DPT.

Hartimi dhe validimi i 420 Kartelave Informative në fjalë jo vetëm ka përmbushur nevojën e informimit të qytetarëve për mënyrën e përfitimit të shërbimeve publike, të ofruara nga 10 institucionet në fokus fillestar, gjithashtu ka kontribuar në rritjen e sigurisë së qytetarëve sa i takon mbledhjes dhe paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e shërbimit të kërkuar. Validimi i Kartelave Informative përjashton njëherazi mundësinë e shtimit, ndryshimit apo reduktimit nga ana e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimit të kriterëve formale për përfitimin e shërbimit (të dokumentacionit të kërkuar). Kjo përket në parandalim të çdo mundësie abuzimi nga institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit për ndryshimin e kriterëve të përcaktuara për ofrimin e shërbimit, njëherazi shmang moslëvrimin e shërbimit nga ana e institucionit përgjegjës apo tejkalim të afateve për lëvrimin e tij bazuar në justifikimin e mospërmbushjes të kriterit/kriterëve formale të tjera apo të reja për përfitimin e shërbimit, të përcaktuara shpesh *ad hoc* nga institucioni përgjegjës.

Më poshtë një paraqitje e Call Center:



Rrjedhimisht, është rritur qartësia e siguria e qytetarit sa i takon mënyrës së përfitimit të shërbimit mbi bazën e kriterëve të qarta, shteruese e transparente për përfitimin e shërbimit publik, ashtu siç përcaktohet në Kartelën Informative përkatëse, si dhe i janë vënë në dispozicion qytetarit kanale të shumëfishta për t'u informuar për mënyrën e përfitimit të shërbimeve publike (qoftë në zyrat pritëse ADISA apo ato të institucionit përkatës, Qendrat e Integruara ADISA, në portalin e-Albania apo në Call Center-in ADISA).

Indikatori 8.a: Numri i shërbimeve me procedura të thjeshtëzuara për ofrimin e tyre

Shënim : Hartimi dhe miratimi i shërbimeve me procedura të thjeshtëzuara është në proces në kuadër të riinxhinierimit.

Indikatori 8.b: Niveli (%) e kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve

Me qëllim matjen e nivelit të kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet publike, janë anketuar qytetarë përgjatë 12 muajve të fundit lidhur me përvojën e tyre gjatë marrjes së shërbimeve publike. Të anketuarit janë pyetur nëse kanë patur nevojë për marrjen e një shërbimi publik ose nëse kanë aksesuar shërbime të tilla të 16 institucioneve në fokus¹⁹ të matjes së nivelit të kënaqshmërisë. Të anketuarit, të cilët kanë pohuar aksesimin e shërbimit në njërin prej 16 institucioneve, janë pyetur më tej për të dhënë vlerësimin rreth marrjes së shërbimit të kërkuar.²⁰

Gjetjet e studimit prezantohen në përqindje për të gjithë kampionin dhe të disagreguar sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor, punësimit, nivelit të të ardhurave dhe përkatësisë së grupit etnik.

Pothuajse gjysma e të anketuarëve (51%) të cilët kanë kontaktuar institucione të qeverisjes qendrore kanë deklaruar se janë "Deri diku të kënaqur" ose "Shumë të kënaqur" me të gjithë përvojën e procesit të shërbimit.




Ka më shumë femra të kënaqura me përvojën lidhur me shërbimet publike sesa meshkuj (57% me 47% respektivisht).




Gjithashtu, personat më të vjetër në moshë deklarojnë se janë më të kënaqur me shërbimet publike sesa moshat e reja (57% e të anketuarëve mbi 55 vjeç janë të kënaqur, në krahasim me 49% e të anketuarëve më pak se 55 vjeç).

¹⁹ Numri i institucioneve në fokus të matjes së nivelit të kënaqshmërisë është 16, përpos bashkimit të QKR dhe QKL në një (me krijimin e QKB), duke qenë se të anketuarit janë pyetur veçan për secilin prej këtyre dy institucioneve.

²⁰ Llogaritja e treguesit: Përqindja e të anketuarëve të cilët kanë kontaktuar për të marrë një shërbim publik gjatë 12 muajve të fundit, dhe që deklarojnë për të gjitha institucionet e kontaktuara të jenë ose "deri diku të kënaqur" ose "të kënaqur" me shërbimin e marrë. Kampioni përfaqësues i popullsisë është 2,000 intervista me persona të moshës mbi 18 vjeç. Vrojtimi është realizuar përmes intervistës ballë për ballë, në periudhën Mars-Prill 2016.



Të ndarë sipas “Indeksit të pasurisë”, rreth 53% e “të varfërve” deklarojnë se janë “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” krahasuar me 49% të “të pasurve” që deklarojnë të njëjtën gjë.



Edhe në rastin e komunitetit Romë, përqindja e atyre që janë të kënaqur me shërbimet publike është 52% e atyre që kanë kontaktuar të paktën një institucion në 12 vitet e fundit: përqindje kjo e përafërt me gjetjen për popullatën e gjerë.



Nuk ka diferenca në nivelin e kënaqësisë midis të anketuarëve nga zonat urbane dhe atyre nga zonat rurale: të dy këto kategori shënojnë nivelin 51%.



E disagreguar sipas nivelit arsimor, përqindja për nivelin e kënaqësisë është 44% për ata me arsim universitar dhe pasuniversitar, 54% mes atyre me më të shumtën arsim të mesëm dhe 52% ndërmjet atyre me më të shumtën shkollë fillore.



Niveli bazë i Indikatorit “Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërvëprim të përmirësuar në zyrat e pritjes” lidhur me Objektivin 8 “Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin” për vitin 2015 nuk është i përcaktuar. Niveli faktik i këtij indikator për vitin 2016 është 0 duke qenë se produktet e konsulencës për riinxhinierimin e shërbimeve publike të 10 institucioneve në fokus ende nuk janë miratuar nga institucionet në fjalë. Rrjedhimisht nuk shënohet progres.

Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2017²¹ janë për pasojë në nivelin 0%.

Për sa i përket Indikatorit “Niveli (%) e kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve”, në vitin 2016 u mat për herë të parë ky tregues.

Niveli bazë për vitin 2016 i këtij indikator për vitin 2016 është 51%, duke patur një progres në rritje për këtë indikator.

Zhvillimi i Infrastrukturës së TIK po konsiderohet një element rëndësishëm jo vetëm për të rritur eficienten e punës së administratës publike por gjithashtu për të përmirësuar transmetimin dhe rrjedhjen e informacionit. Me qëllim realizimin e këtij objekti, është prezantuar projekti për menaxhimin e dokumentit elektronik në administratën publike (EDRMS) duke përcjellë një vizion të qartë për rritjen e eficientës dhe efektivitetit brenda qeverisë shqiptare. Kjo platformë ndikon drejtpërdrejt në uljen e barrierave administrative rrjedhimisht ndikon në një performacë të lartë të veprimtarisë të administratës publike. Projekti i ERDMS është pilotuar për herë të parë në Kryeministri, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë si dhe Ministrinë e Transportit. Gjatë vitit 2016 janë bërë ndryshime për përmirësimin e ëorkfloët të sistemit nga NJMLP (Njësia e Monitorimit të Legjislacionit dhe Programeve) pranë Kryeministrit. Në datat 1-2, 8-9, 15-16, 22-23 Dhjetor janë trajnuar specialistet IT të ministrive të linjës për rolin e administratorit, protokollit dhe të përdoruesit

²¹ Niveli i ri i synuar për vitin 2017 është 150 (referuar Pasaporta e Indikatorëve, fq. 24).

Risk që lidhet me mirëfunksionimin e sistemit ERDMS nga administrata publike është mungesa e trajnimit nga IT tek punonjësit e Ministrive të linjës, në varësi të funksioneve që ushtrojnë, të cilat lidhen me menaxhimin e dokumentacionit në sistemin ERDMS, duke sjellë si rezultat vështirësi në përdorimin e sistemit. Hapat që synojnë realizimin e këtij aktiviteti janë zhvillimi i trajnimeve dhe asistencë nga ana e IT për stafin e institucioneve respektive gjatë procedurave të para të përdorimit të sistemit ERDMS.

Në zbatim të iniciativave të ndërmarra në portalin unik qeveritar, është ridimesionuar totalisht mënyra e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit dhe biznesit. Tri vjet më parë vetëm 14 shërbime elektronike ofroheshin në portalin unik qeveritar e-Albania.

Në maj të vitit 2015 u prezantua versioni i ridizajnuar plotësisht i portalit unik qeveritar **e-Albania**. Portali vjen në formë më të thjeshtë, më të lehtë dhe më praktike gjithashtu i përshtatur për celularë, për Android dhe IOS, ku qytetarët shqiptarë, bizneset dhe punonjësit e administratës publike në nivel qendror mund të përdorin të gjitha shërbimet dhe funksionalitetet e portalit. Ndërhyrjet e kryera nga AKSHI me qëllim lehtësimin e përdorimit të portalit unik qeveritar e-Albania për shtetasit shqiptarë, bizneset dhe nëpunësit publikë, ka rezultuar në rritjen e përdorimit të këtij portalit në një mënyrë të qëndrueshme.

Gjatë vitit 2016 portali qeveritar e-albania është pasuruar me **217 shërbime të reja elektronike** të nivelit 3 dhe 4 sipas klasifikimit të UNPAN 2014, duke arritur **një total prej 465 shërbimesh elektronike**. Kjo shifër shënon një rritje prej 33 herësh krahasuar me vitin 2013 si dhe një rritje pothuajse dyfish krahasuar me vitin 2015. Në portal janë regjistruar 71.703 përdorues të rinj (4% biznese dhe 96% qytetarë), duke e çuar kështu numrin total të përdoruesve të regjistruar në 241 621. Totali i përdoruesve që kanë marrë asistencë për vitin 2016 është **5466**. Për vitin 2017 parashikohet dixhitalizimi i mbi 100 shërbimeve të tjera të administratës publike.

Shërbimet elektronike që ofrohen ofrohen sipas kategorive:

- Biznes – 146
- Qeveritar – 4
- Qytetar – 226
- Qytetar/Biznes - 86
- Qytetar/Biznes/Qeveritar – 3

Gjatë 2016, në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit u lidhën 5 institucione të tjera për të shkëmbyer të dhëna në kohë reale duke e rritur numrin total të institucioneve të lidhura në **42** ose 7 herë më të madh se ai në vitin 2013. Kjo lidhje bën të mundur komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave midis institucioneve të ndryshme duke krijuar mundësinë e ofrimit të më shumë shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe vet qeverinë.

Numri i transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit gjatë vitit 2016 ishte rreth **25.57 milionë**:

- rreth 37,43 herë më e lartë se numri i transaksioneve të kryera gjatë gjithë vitit 2013 (683 207 transaksione gjatë këtij viti);
- 8,86 herë më e lartë se numri i transaksioneve të kryera gjatë gjithë vitit 2014 (i cili është rreth 2.88 milionë)
- 2,24 herë më e lartë se numri i transaksioneve të kryera gjatë gjithë vitit 2015 (i cili është rreth 11.42 milionë).

Në vitit 2015 u ndërrmor një tjetër iniciativë për të lehtësuar aksesin e qytetareve dhe bizneseve në shërbimet elektronike të ofruar nga portali unik qeveritar e- Albania. Në këtë kuadër gjatë vitit 2016 ka përfunduar me sukses shpërndarja e 15 sporteleve dixhitale e-albania në qytetet më të rëndësishme në Shqipëri si Bashkia Tiranë, Bashkia Shkodër, Bashkia Korçë, Bashkia Vlorë, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Elbasan, Elkos Trading Center Fier, ADISA Tiranë (sportelet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), DPSHTRR Tiranë, QKB Tiranë, FSDKSH Tiranë, Bashkia Sarandë, FlagShip Center Durrës, Adisa Fier (për t'u dorëzuar në momentin e hapjes së qendrës), Adisa Kavajë.

Një iniciativë e re e ndërmarrë gjatë vitit 2016 me qëllim rritjen e pjesëmarrjes publike në procesin e vendimarrjes dhe ligjvënies, ishte implementimi i sistemit për njoftim dhe konsultim publik. Në këtë sistem krijohet një projekt-akt përfundimtar i cili përmban projekt aktin fillestar së bashku me gjithë sugjerimet (e përzgjedhura për reflektim nga moderatorët) si dhe me të dhëna shtesë raportuese si psh. votimet e përdoruesve në sondazhe. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2016, është krijuari Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) si dhe integrimi i RENJK në portalin e-Albania duke shfrytëzuar teknologjinë FPSTS të portalit, për Single Sign On.

Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës TIK për bizneset dhe qytetarët AKSHI ka realizuar projektin për Sistemin Multifunksional i Qendëruar i Lejeve të Ndërtimit, i cili është funksional që nga viti 2016. Nëpërmjet këtij sistemi është dixhitalizuar i gjithë procesi i punës i institucioneve të përfshira për trajtimin e lejeve, si dhe i është dhënë mundësia qytetarit dhe biznesit ta përfitojë këtë shërbim online, nëpërmjet portalit e-albania. Prej 1 shtatorit e deri më sot, janë kryer mbi 1500 aplikime ndërsa shërbimi është përdorur mbi 25 000 herë nga qytetarët dhe bizneset. Aktualisht sistemin e aksesojnë 1155 përdorues (punonjës të administratës publike) nga të gjitha institucionet e përfshira në trajtimin e aplikimeve të lejeve të ndërtimit.

Implementimi i shërbimeve online për Ministrinë e Punëve të Jashtme është një projekt tjetër i realizuar gjatë vitit 2016, me qëllim zhvillimin e infrastrukturës TIK, i cili synonte dixhitalizimin e 36 shërbimeve të ofruara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Përfaqësive Diplomatike dhe Konsullore në portalin e shërbimeve unike qeveritare e-albania.al. Nëpërmjet përdorimit të sistemit të ri të aplikimeve, dukuritë e korrupsionit goditen në burim, pasi raporti mes aplikuesit dhe ofruesit të shërbimit kalon në një proces që detyrimisht lë gjurmë. Implementimi i shërbimeve online për Ministrinë e Jashtme përfundoi me sukses brenda vitit 2016, duke realizuar publikimin e 36 shërbimeve elektronike në portalin qeveritar e-albania në muajin nëntor dhe dhjetor 2016, përshtatje e faqeve të internetit të çdo konsullate me elementet: trokitje virtuale, tur virtual në 3D për çdo konsullatë dhe orientimin e vizitorëve të faqeve në paketën e shërbimeve. Shërbimet elektronike që

janë tanimë aktive përmes portalit e-albania, japin përgjigjen optimale për kërkesat përherë e më të mëdha në adresë të zyrave konsullore shqiptare.

Gjatë vitit 2016 është realizuar projekti për sistemin e menaxhimit të radhës për ekzaminime të avancuara mjekësore, i cili administrohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe bën të mundur rezervimin online nga shtetasit për ekzaminimet e avancuara mjekësore. Në muajin dhjetor janë publikuar në portalin e-albania 34 shërbime elektronike që mundësojnë rezervimin e radhës për ekzaminimet e avancuara mjekësore, konsultimin online të rekomandimeve të marra nga mjeku dhe mundësinë e ngarkimit të një rekomandimi të skanuar, për të bërë më pas rezervimin e radhës në bazë të këtij rekomandimi (në rastet kur rekomandimi nuk është ngarkuar nga mjeku).

Risqet dhe masat mbrojtëse

Risk që lidhet me implementimin e shërbimeve online është trajtimi në kohën e duhur dhe me saktësi i aplikimeve të qytetarëve për 36 shërbimet elektronike të MPJ-së, të dërguara përmes portalit qeveritar e-albania. Trajnimi i konsujve, ambasadorëve apo personave përgjegjës (të ndodhur në dhjetëra shtete të botës ku shteti shqiptar ka përfaqësi) që do të trajtojnë aplikimet është drejt fundit. Procesi i trajnimeve është duke u mbikëqyrur duke iu dhënë suport të vazhdueshëm të gjithë aktorëve të përfshirë, në problematikat me të cilat mund të hasen gjatë procesimit të aplikimeve.

Risk që lidhet me këtë projekt është trajnimi i gjithë aktorëve të përfshirë në sistem, si mjekët të cilët ngarkojnë rekomandimet e dhëna për pacientët apo interpretimin e rezultatit të ekzaminimit, personat e autorizuar për të modifikuar apo kërkuar ndryshim të variablave të sistemit (si psh, pasqyrimi në kohë reale në sistem i pajisjeve mjekësore që janë jashtë funksionit) etj. Bashkëveprimi i gjithë aktorëve është thelbësor në funksionimin e plotë të sistemit në funksion si të qytetarit, ashtu edhe të shërbimit mjekësor.

Në kuadër të **Objektivit 10: Rritja e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë** janë parashikuar gjithsej 4 aktivitete, nga të cilat 2 kanë filluar të zbatohen gjatë vitit 2016. Ndër këto 2 aktivitete për të cilat ka filluar zbatimin 1 është realizuar plotësisht.

Ndërkaq, Kodi i Ri i Procedurave Administrative sjell një qasje re, ndaj dhe rëndësi të veçantë në këtë kuadër merr trajnimi i punonjësve publik në mënyrë që të njihen me procedurat e reja sa i takon zbatimin të Kodit.

Gjatë vitit 2016, Departamenti i Administratës Publike së bashku me Projektin e Binjakëzimit IPA 2012, në kuadër të implementimit të Kodit të Ri të Procedurave Administrative, si pjesë e Komponentit 2 të këtij Projekti, ndërmori një sërë aktivitete me synim rritjen e sensibilizimit mbi risitë që do të sjellë Kodi i Ri dhe familjarizimin e gjerë me të si dhe organizimin e disa sesioneve trajnimi, më konkretisht

Ndërgjegjësimi dhe vizibiliteti mbi Kodin e Ri të Procedurave Administrative	✓ Fushatë ndërgjegjësimi në lidhje me risitë në Kodin e ri të procedurave administrative, organizuar për aktorë të ndryshëm 254 pjesëmarrës nga institucionet e administratës qendrore, institucionet e varësisë, gjykatës, avokatë, përfaqësues të universiteteve, etj. ✓ 3 materiale shpjeguese mbi parashikimet e Kodit të Ri të Procedurave Administrative, me qëllim shpjegimin sa më thjeshtë të tyre për qytetarët: ○ Mënyrat për të kundërshtuar një vendim; ○ Të drejtat e qytetarëve; ○ Afatet kohore
Sesioni trajnimi mbi Kodin e Ri të Procedurave Administrative	✓ Sesioni trajnimi mbi implementimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative: 391 pjesëmarrës ⇒ 57 – Shkolla e Magjistraturës (gjykatës administrative dhe studentë) ⇒ 334 – Nëpunës civil të trajnuar së bashku me ASPA (sekretarë të përgjithshëm, drejtorë të përgjithshëm, drejtorë drejtorie, specialist të burimeve njerëzore, specialist ligjorë, nga institucione të administratës qendrore, institucionet e varësisë dhe të pavarur) ✓ Seminar mbi ‘heshtjen administrative’

Gjatë vitit 2016 progres të veçantë në zbatimin e aktiviteve që lidhen me forcimin e rregjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publike, rasteve të konfliktit të interesave, si dhe mbrojtjes të të drejtave të sinjalizuesve për rastet e deklarimit të veprimeve auizive apo korrupsionit. Në Qershor 2016 u miratua Ligji nr.60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (botuar në fletoren zyrtare nr.115, dt.23.6.2016). Efektet juridike të këtij ligji shtrihen prej datës 1 tetor 2016 me përjashtim të detyrimeve për sinjalizimin e brendshëm për subjektet private, që fillojnë të zbatohen nga data 1 korrik 2017.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar u miratua VKM nr. 816 datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike” (botuar në Fletoren Zyrtare nr.229 datë 25 Nëntor 2016). Me anë të këtij vendimi të gjitha autoritetet publike me mbi 80 punonjës njoftojnë ILDKPKI për krijimin e njësisë.

ILDKPKI gjithashtu në zbatim të ligjit të sipërcituar miratoi një udhëzim dhe dy rregullore të cilat do të përcaktojnë strukturat dhe mënyrat e hetimit administrativ të sinjalizimeve²². Ky është një mekanizëm për parandalimin e korrupsionit, i njohur dhe pranuar nga praktikantët më të mira në botë.

Për arsye se VKM 816, datë 16.11.2016, u miratua më vonë seç ishte parashikuar, gjatë vitit 2016 nuk janë kryer trajnime të NC. Kjo masë parashikohet të realizohet brenda 6-mujorit të parë 2017.

Me miratimin e ligjit për të Drejtën e Informimit në rëndësi e veçante i është kushtuar edhe objektivit **të rritjes së kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.**

Gjatë vitit 2016, Zyra e Komisioneri ka vijuar punën e saj lidhur me monitorimin e implementimit të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Numri i ankesave të depozituara pranë Zyrës së

²² 1 - Udhëzimin nr. 1, datë 23.9.2016 “Për miratimin /përcaktimin e strukturës, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit e punonjësve të njësisë përgjegjëse në subjektet private”.

2 - Rregulloren nr. 2, Shtator 2016 “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në I.L.D.K.P.K.I.”

3 - Rregulloren nr. 3, Shtator 2016 “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në I.L.D.K.P.K.I.”


Komisionerit ka arritur në 684, ku 547 prej të cilave janë zgjidhur me ndërmjetësim, për 36 ankesa Komisioneri është shprehur me vendim, 65 kanë rezultuar jashtë objektivit, 7 jashtë afatit dhe 29 kanë qenë të paplota.

Gjatë vitit 2016 janë kryer gjithsej 95 inspektime me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Komisioneri për të drejtën e informimit ka marrë tre vendime me sanksion administrativ gjobë, ndaj personave përgjegjës për mosvënje në dispozicion të informacionit të kërkuar.


Indeksi i sanksioneve të vëna për vitin 2016 është 0.03.

Hartimi dhe miratimi i programeve të transparencës nga ana e Autoriteteve publike mbetet ende problematik por ka një numër në rritje të institucioneve që kanë përmbyshur këtë detyrim.

Duhet theksuar që gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit ka punuar për të rishikuar databazën e Autoriteteve Publike dhe pikërisht për këtë arsye, me asistencën e ekspertëve të SIGMA, ka hartuar një udhëzues për funksionimin e Autoriteteve Publike. Prandaj në grafikun e mëposhtëm vihet re një ndryshim në numrin e disa prej kategorive të Autoriteteve publike p.sh. në vitin 2015 janë 145 institucione që bëjnë pjesë në kategorinë institucione qendrore ndërsa në vitin 2016, pas rishikimit të databazës së institucioneve, janë 202 institucione që bëjnë pjesë në këtë kategori. Sqarojmë se këto institucione në vitin 2015 bënin pjesë në kategorinë **Të tjera**, prandaj si pasojë kanë ndryshuar dhe numri i institucioneve për këtë kategori.



Nga grafiku i mësipërm vihet re se janë 46 institucione më shumë që kanë hartuar programin e transparencës gjatë këtij viti.



Për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarëve por edhe për të rritur nivelin e njohurive të punonjësve të administratës publike, Zyra e Komisionerit ka vijuar me trajnimet nëpër rrethe (janë zhvilluar 4 trajnime në Qarkun Berat, Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë) si dhe me trajnimet pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Gjatë vitit 2016 janë organizuar 10 trajnime, ku kanë marrë pjesë 335 nëpunës civil në periudhe prove, të Ministrive të linjës dhe institucioneve të varësisë. Gjithashtu është realizuar dhe një tajmin me 35 nëpunës civil të Inspektoratit të ILDKPK.

Për përmbushjen e objektivave të parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale për reformën në administratë publike, Zyra e Komisionerit ka përdorur vetëm burimet e saj të brendshme qofshin ato financiare apo burime në kapital njërëzor.

Numri i ankesave të depozituara pranë Komisionerit Për të Drejtën e Informimit në vitin 2016 të vlerësuara në favor të qytetarit²³ 684 ankesa.


Gjatë vitit 2016 janë realizuar 95 inspektime pranë Autoriteteve Publike me synim verifikimin e ankesave të depozituara.

Indeksi i sanksioneve të vëna gjatë vitit 2016 kundrejt inspektimeve është në masën 0.03

Ende mbetet shqetësim reagimi në kohë nga ana e institucioneve publike ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit. Për vitin 2016, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 319 rekomandime drejtuar institucioneve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore.

²³ Numri i Ankesave të cilësuar si të drejta është llogaritur duke zbritur nga numri total i ankesave (274) numrin e ankesave jashtë objektit të ligjit 119/2014 (19), numrin e ankesave të paplota (5) dhe numrin e ankesave jashtë afatit.

Treguesi i Zbatimi të Rekomandimeve të Avokatit të Popullit



Nga numri total i rekomandimeve të adresuara janë pranuar 197 rekomandime, nga të cilat rezultojnë se vetëm 93 prej rekomandimeve të pranuar, kanë gjetur zbatim të plotë. Pra, referuar raportit të rekomandimeve të pranuar me rekomandimet e zbatuara, rezultojnë se 47.2% e rekomandimeve të pranuar kanë gjetur zbatim nga institucionet përkatëse.

Lidhur me rekomandimet pa përgjigje, evidentojmë se 70 rekomandime për vitin 2016, rezultojnë pa përgjigje. Pra, në përputhje me raportin midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit rezultojnë se 21.9 % e rekomandimeve të adresuara nuk kanë përgjigje.

Lidhur me numrin e kërkesave për informacion, rezultojnë se për vitin 2016, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 3053 kërkesa për informacion, prej të cilave 158 prej tyre rezultojnë pa përgjigje, ose 5.1% e kërkesave për informacion të adresuara nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

Në konkluzion të statistikave të mësipërme, për periudhën 2015-2016 rezultojnë dhe sikundër evidentohet ka një rritje të numrit të rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucionet e Administratës Publike, por është ulur përqindja e rekomandimeve të zbatuara. Ndërkohë që edhe lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezultojnë se për vitin 2016 janë më shumë rekomandime pa përgjigje, krahasuar me vitin 2015.

Risqet kryesore dhe masat mbrojtëse

Një nga risqet e mundshme që do të ndikojë në ecurinë e zbatimit të objektivave dhe indikatorëve është mungesa e fondeve të parashikuara për realizimin e plotë të funksioneve të administratës publike. Edhe pse numri i punonjësve që merret me shqyrtimin e ankesave për të drejtën e informimit, është rritur me 2.5 herë, ende ka mungesë të stafëve që duhet të merren me hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programit të transparencës.

- Aktivitetet prioritare për vitin 2017

- Shtimi me 115 shërbime elektronike nga kontrata “Shtimi i 209 shërbimeve të reja elektronike në portalin e-albania”, e cila është aktualisht në implementim. Pritet që numri i e-shërbimeve brenda vitit të shkojë mbi 580.

- Shtimi në Platformë n Qeveritare të Ndë rveprimit i 5 institucioneve të tjera duke arritur në total shifrën 47.

4. Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2017

Sfida më e madhe më të cilët do të mund të përballen zbatimi i Strategjisë në vitin 2017 do të jetë ndikimi që mund të sjellë në vendimarrje dhe në eficienten e administratës publike ***procesi i zgjedhjeve parlamentare***. Funksionimi normal i administratës mund të ketë ndikime të drejtperdrejta ose indirekte që mund të vijnë si rezultat i situatës politike në vend. Qeveria do të marrë masat që efektet e kësaj krize të jenë sa më të pakta në nivelin operacional. Në aspektin vendimarrës, pjesa më e madhe e ligjeve tashmë janë aprovuar gjatë vitetve 2015-2016 duke eliminuar në këtë mënyrë efektin që mund të kishte reforma në aspektin e procesit legjislativ.

Zbatimi i reformave të parashikuara në nivelin e politikbërjes ndeshet me sfida apo risqe që lidhen në nivele të brendshme dhe mikro apo sektoriale. Sfida të tilla mbeten në nivel planifikimi qendror, politikash dhe koordinimi, madje edhe të një natyre ndër-sektoriale, e cila mund të ketë impakt në realizimin e aktiviteteve dhe rezultateve të dëshirueshme.

Kapacitetet e administratës si në aspektin e kapaciteteve njërëzore dhe në aspektin e njohurive vazhdon të mbetet një nga sfidat më të rëndësishme të reformës së administratës publike. Numri i limituar i stafëve në disa njësi si dhe kufizimi i kapaciteteve përthithëse ndikon si në performancën dhe në nivelin e zbatimit të disa nga aktivitetet/reformat e parashikuara në strategji. Në mënyrë të veçantë mund të përmenden kapacitetet në kuadër të monitorimit të kuadrit strategjik dhe monitorimit të proceseve të transparencës dhe informimit të publikut.

Sigurimi në kohë i infrastrukturës, ngritja e një sistemi të monitorimit të proceseve të punës e të mënyrës së ofrimit të shërbimeve dhe trajnimi i stafëve përkatëse do të jenë sfidat kryesore më të cilat do të ndeshet zbatimi i shërbimeve online për qytetarët nëpërmjet Qendrave të Integruara ADISA.

SNRAP në vitin e parë u përball më një nga sfidat kryesore mungesën e burimeve të plota financiare për zbatimin e saj. Me qëllim përballimin e nevojave Qeveria vendosi në dispozicion të zbatimit të strategjisë burime të brendshme financiare në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm, si dhe u bë e mundur mobilizimi i fondeve nga programi IPA dhe donatorë të tjerë. Monitorimi i vazhdueshëm nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ishte një faktor i kësaj që ndikoi në mobilizimin e fondeve nga Qeveria brenda kufizimeve buxhetore. Pavarësisht nga ky progres një nga çështjet teknike që ende ka mbetur sfida është sigurimi që institucionet që kanë masa për të realizuar në strategjitë ndërsektoriale nën sektorin e PAR, të bëjnë kërkesa në programet e tyre buxhetore përkatëse për mbulimin e këtyre masave. ***Mbledhja e të dhënave statistikore për disa fusha edhe zbatimi në mënyrë të disiplinuar dhe sistematik i proceseve të monitorimit*** ka qënë një nga sfidat më të cilat u përball strategjia në disa fusha dhe do të vazhdojë të përballen nëse nuk do të ngrihet një sistem frekuent i mbledhjes së vazhdueshme e përpunimit të të dhënave.

Gjatë periudhës Mars – Gusht 2017 pritet të realizohet ***vlerësimi afatmesëm i strategjisë*** me ndihmën e Këshillit të Europës. Rezultatet e vlerësimit do të jenë shumë të rëndësishme për të vlerësuar arritjen e objektivave të parashikuara në kuadër të politikave të parashikuara në SNRAP,

rishikimit të tyre të mundshëm si dhe dizenjimit të planit të ardhshëm trevjeçar për periudhën 2018 – 2020. Angazhimi në këtë proces i të gjithë strukturave përgjegjëse për realizimin e politikave në kuadër të strategjisë, zbatimi i një procesi konsultativ sa më transparent dhe efektiv me grupet e interesit, do të jetë shumë i rëndësishëm për hedhjen e hapave të ardhshme në drejtim të forcimit të reformave të administratës publike.

Së fundi, një nga sfidat mbetet dhe ***prezantimi i sinqertë dhe i hapur i problemeve që ndeshën në zbatimin e strategjive***. Kjo kërkon një ndryshim në kulturën e punës së administratës shqiptare: kulturën e analizës dhe evidentimit të problematikave në mënyrë sa më objektive. Hapa pozitive u vunë rë në procesin e hartimit të këtij raporti, me evidentimin e disa nga risqeve dhe sfidave me të cilat do të haseshin realizimi i aktiviteteve në disa fusha. Megjithatë, kjo kërkon një qasje sa më sistematike dhe gjithë përfshirëse në të gjitha nivelet teknike, menaxheriale dhe politike.